



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 70022-00558-00-2023 Regj. Themeltar  
Nr. 00-2024-1222 i Vendimit (69)**

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtaret:

<b>Ilir PANDA</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Sokol BINAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Sandër SIMONI</b>	<b>Anëtar</b>

Sot, më datë 12.03.2024, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen penale me nr. 70022-00558-00-2023 akti, që i përket:

**KËRKUESE:** Rajmonda Nika

**ME OBJEKT:** **Ankim** kundër vendimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Nr.K.137/1 Prot. A.Sh., datë 24.02.2023, për deklarimin e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e çështjes (kallëzimit) - kundër të kallëzuarve Sali Berisha, ish - Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, Lulzim Basha, ish - Ministër i Brendshëm dhe Ndrea Prendi, ish - Komandant i Gardës së Republikës - në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Neni 3 i ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

**KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Sokol Binaj, avokatin Idajet Beqiri, përfaqësues i kallëzueses Rajmonda Nika, i cili kërkoi pranimin e rekursit dhe urdhërimin e Prokurorisë së Posaçme për të regjistruar procedimin dhe hetuar çështjen penale, prokurorin pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Alfred Shehu, i cili kërkoi mospranimin e rekursit; dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Më datë 16.02.2023, nga shtetasit Mahmude Myrtaj, Rinaldo Myrtaj, Rajmonda Nika, Çauş Veizi, Zabit Deda, Ilvi Deda, Trandafila Muhameti dhe Ana Veizi, është paraqitur pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar një kallëzim penal. Të kallëzuar nëpërmjet këtij kallëzimi penal janë shtetasit Sali Berisha (ish - kryeministër i RSH, në rolin e organizatorit), Lulzim Basha (ish- ministër i Punëve të Brendshme, në rolin e organizatorit), Andrea Prendi (ish - komandant i Gardës së Republikës, në rolin e organizatorit, nxitësit dhe ekzekutorit), si dhe ndaj shtetasit Agim Llupo (në rolin e ekzekutorit). Këta shtetas janë kallëzuar për kryerjen e veprës penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", kundër dy ose më shumë personave, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, veprë që parashikohet nga nenet 79-28 të Kodit Penal, në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe në shkelje të ligjit për përdorimin e armëve të zjarrit, pasi, më datë 21.01.2011, kanë shkaktuar vdekjen e të ndjerëve Aleks Nika, Zyver Veizi, Hekuran Deda dhe Faik Myrtaj, si dhe plagosjen e shumë personave – pjesëmarrës në manifestimin e protestës të organizuar në këtë datë nga forcat opozitare të kohës, në bulevardin para selisë së kryeministrit - të cilët në kohën që është kryer vepra ndodheshin jashtë zonës rrethuese të godinës së kryeministrit. Sipas palës kallëzuese, (me këtë cilësi janë paraqitur, sikurse u evidentua, sa me sipër, familjaret e viktimave të kësaj ngjarje) kjo veprë është kryer në një kohë kur tubimi i organizuar nga opozita e kohës kishte përfunduar. Baza ligjore e kallëzimit (paraqitjes së tij) – sipas kërkesave – identifikohet në përcaktimet e nenit 280 (Prokurori dhe policia gjyqësore marrin dënim për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët) në lidhje me nenin 283 të Kodit të Procedurës Penale (i cili – në paragrafin e parë të tij parashikon se – Çdo person që ka marrë dënim për veprën penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Ndërsa në paragrafin e dytë parashikon se:- kallëzimi i paraqitet prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore, me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.) dhe se Prokuroria e Posaçme (ku kallëzimi është paraqitur) është i vetmi organ kompetent për hetimin e subjekteve të kallëzuar.

2. Kallëzimin e tyre e mbështesin në një sërë faktesh, pjesa më e madhe e të cilave është e njohur botërisht. Të tilla janë publikimet në kohë reale të ngjarjes, të ekspozuara në kohë reale nga të gjitha televizionet shqiptare dhe më gjerë, fakte që në pamundësi të kallëzuesve për t'i disponuar, i takojnë prokurorisë që t'i administrojë dhe t'i përdorë si provë. Në vijim të kallëzimit penal, kallëzuesit parashtrajnë se të tilla janë - urdhrat e prokurorit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për ekzekutimin (menjëherë mbas ngjarjes) e ndalimeve procedurale të komandantit të gardës dhe zinxhirit komandues të atij institucioni – dokumente (akte) të recuperueshme - prej organit të procedimit penal – Prokurorisë së Posaçme – pranë arkivave të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Prokurorisë së Përgjithshme – dhe të përdorshme në cilësinë e burimeve të provës mbështetese të verifikimit të vërtetësisë së njoftimit të marrë nëpërmjet këtij kallëzimi. Në këto arkiva - sipas palës kallëzuese – është i konsultueshem dhe i recuperueshem edhe dokumentacioni pasqyruar dhe evidentues i dëmtimeve fizike (plagosjes) të shumë personave të tjerë që kanë marrë pjesë në tubim - të qëlluar me armë në konkludim të tij në momentin e largimit nga vendi i zhvillimit - hapësira para selisë së Kryeministrit. Pala kallëzuese parashtron - në mbështetje të përmbajtjes së kallëzimit – të cilësisë së tij për të disponuar rekuizitat e regjistrueshmerise, sipas përcaktimit të nenit 287/1 të K.Pr.Penale – pra në thelb – të cilësisë së “njoftimit për veprën penale” – notitia criminis – se prova të mirëfillta implikuese të pjesëmarrjes së ish - kryeministrit në drejtimin dhe organizimin e reagimit të finalizuar me vrasjen e katër personave dhe plagosjen e shumë të tjerëve – konsiderohen - moslejimi nga ish – kryeministri – bllokimi i ekzekutimit të urdhrave të ndalimit të nxjerra nga prokurori ndaj personave të zinxhirit komandues të Gardës së Republikës - deklaratimet e ketij të fundit - përpara kamerave të televizioneve të ndryshme që përmbajnë justifikime të papranueshme ligjrisht dhe - në mënyrë të veçantë - deklarimi publik i ish kryeministrit Berisha, sipas të cilit njëri prej viktimave kishte plagë trupore të shkaktuara nga shumë atër me

një armë zjarri në formën e çadrës. Ish kryeministri në lidhje me këtë deklaram është shprehur se e bazonte në konstatimin e mjekut të spitalit Ushtarak, ku ishte dërguar trupi i viktimës. Nga ana e kallëzuesve theksohet se administrimi i deklaramit shërben si provë për të krijuar alibi lidhur me mekanizmin real të ngjarjes. Në vijim nga kallëzuesit parashtrahet se fakt tjetër i rëndësishëm që provon pjesëmarrjen aktive të ish kryeministrit në këtë ngjarje është shkatërrimi (zhdukja) e serverit të Kryeministrit. Punonjësi i administrimit ishte nën kontroll ekskluziv të ish kryeministrit. Provat lidhur me verifikimin e kesaj situatë gjenden në fashikullin gjyqësor (hetim dhe gjykim të këtij punonjësi). Si provë direkte për pjesëmarrjen aktive të ish ministrit të brendshëm janë edhe ekspozimet e shumta të tij në tarracën e godinës së kryeministrit dhe largimi i shpeshtë i tij prej saj. Si provë direkte për pjesëmarrjen aktive të ish kryeministrit në këtë ngjarje, kallëzuesit shprehen se do të shërbejnë dhe administrimi i deklaramit publik në mënyrë të përsëritur që ka bërë gazetari investigativ Artan Hoxha. Sipas këtij të fundit disponohet një kasetë audio në përmbajtjen e të cilës - përveç ish komandantit të Gardës dëgjohet edhe pjesëmarrja aktive e ish kryeministrit. Disponimi dhe administrimi i kesaj kasete është në kompetencën ekskluzive të prokurorisë. Si provë indirekte për të krijuar bindjen lidhur me pjesëmarrjen aktive të ish kryeministrit në ngjarje mund të shërbejë deklarami i përsëritur që ai ka bërë deri vonë, duke u shprehur se nëse ish drejtuesi i opozitës i asaj kohe do të organizonte një tubim tjetër që do t'i afrohej godinës së kryeministrit, do te ishte i gatshëm të qëllonte me automatik në drejtim të tij. Gjithashtu, kallëzuesit citojnë se si provë direkte për përpjekjen e personave që kanë marrë pjesë në vrasjen e viktimës Aleks Nika shërben edhe fakti që plumbi i gjetur në trupin e tij është i dëmtuar qëllimisht për të mos u identifikuar jo vetëm autori i qitjes, por edhe fakti që qitja është bërë nga persona të zinxhirit të gardës.

3. Rezulton se kallëzimi penal është paraqitur pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me datë 16.02.2023. Drejtuesi i prokurorisë nëpërmjet shkresës me Nr.K. 137/1.Prot. A/SH, datë 24.02.2023, e ka dërguar këtë kallëzim penal për kompetencë lëndore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Në shkresën e mësipërme, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ka cituar se nga verifikimi i bërë në sektorin e protokoll/arkivës së Prokurorisë së Posaçme evidentohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka regjistruar procedimin penal Nr. 285, datë 21.01.2011, për veprat penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", parashikuar nga neni 79, gjerat "dh" dhe "ë" të Kodit Penal. Me datë 02.04.2021, për këtë procedim penal kanë rifilluar hetimet e pezulluara me qëllim identifikimin e autorëve të vrasjes së shtetasve Aleks Nika dhe Hekuran Deda, si dhe plagosjen e disa shtetasve të tjerë. Gjithashtu, nga informacioni që Prokuroria e Posaçme ka marrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë rezulton se nuk kishte të regjistruar emra të personave që i atribuohet vepra penale. Në vijim drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme shprehet se nga përmbajtja e materialit kallëzues dhe verifikimi i kryer (pavarësisht se kallëzimi penal është depozituar Prokurorinë e Posaçme duke u kallëzuar subjekte të posaçme për kryerje veprash penale në kuadër të një organizate kriminale) evidentohet e dhëna se në lidhje me objektin e kallëzimit penal dhe faktet e pretenduara Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë po kryen hetime në kuadër të procedimit penal Nr.285/2011 për vepra penale që nuk janë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme. Gjithashtu, deri në këto momente të hetimit që po kryhet nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nuk rezulton të jenë identifikuar autorë të veprës penale dhe si rrjedhojë nuk është arritur të provohet se autorë mund të jenë subjekte të posaçme sipas përcaktimeve të nenit 75/a K.Pr.Penale dhe nenit 3, të ligjit Nr.95/2016. Në këto kushte, bazuar në nenet 75/a, 28, 76, të KPP është vlerësuar se kallëzimi penal duhet të përcillet për kompetencë lëndore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me qëllim vlerësimin nga ana e kesaj prokurorie. Në përfundim të shkresës objekt ankimi është cituar se nëse në vijim të verifikimeve apo hetimeve do të konstatohet ekzistenca e ndonjë veprë penale apo subjekt në

kompetencë hetimi sipas nenit 75/a të K.Pr.Penale atëherë aktet e procedimit penal të dërgohen për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Posaçme, referuar edhe nenit 28 të K.Pr.Penale. Kjo shkresë i është komunikuar edhe shtetasit Mark Nika.

4. Më datë 03.03.2023, përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është paraqitur ankim, me palë ankuese (kallëzuesen) Rajmonda Nika me objekt: *“Kundër vendimit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Nr.K.137/1 Prot A.Sh., datë 24.02.2023, për moskompetencë lëndore dhe dërgimin e çështjes kundër të kallëzuarëve Sali Berisha, ish -Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, Lulzim Basha, ish - Ministër i Brendshëm dhe Ndrea Prendi, ish- Komandanti i Gardës së Republikës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.”*

5. Shtetasja Rajmonda Nika, nëpërmjet kërkesës të paraqitur pretendon se - vendimi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Nr.K. 137/1 Prot. A.Sh, datë 24.02.2023, për mungesë të kompetencës lëndore dhe dërgimin e çështjes kundër të kallëzuarëve Sali Berisha, ish - Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, Lulzim Basha, ish-Ministër i Brendshëm dhe Ndrea Prendi ish - Komandant i Gardës së Republikës - në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë - vjen në kundërshtim flagrant me ligjin penal dhe procedural penal, me provat dhe me faktet. Si rrjedhojë, nga pala kërkuese Rajmonda Nika vlerësohet se duhet të vendoset prishja e tij, kthimi i çështjes pranë së njëjtës Prokurori, duke u urdhëruar ajo për të filluar procedimin penal. Në vijim të kërkesës ankimore të paraqitur citohet se kallëzuesja në cilësinë e viktimës së veprës penale - për shkak se me datë 21.01.2011, për motive të dobëta të karakterit politik, nga një organizatë kriminale që kryesohej nga ish - kryeministri Sali Berisha, ish - ministri i brendshëm Lulzim Basha dhe ish - komandanti i gardës së RSH Ndre Prendi, është vrarë me armë zjarri prej ekzekutorëve të kësaj organizate kriminale ish -bashkëshorti i saj - viktima Aleks Nika - ka paraqitur një kallëzim penal pranë SPAK. Kallëzimi është regjistruar në sekretarinë e këtij organi akuze me NR K. 137Prot., datë 16.02.2023. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme me vendimin e tij Nr.K.137/1Prot.A.Sh., datë 24.02.2023, ka shpallur mungesën e kompetencës lëndore dhe ka vendosur dërgimin e çështjes kundër të kallëzuarëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Pala ankuese pretendon se ky vendim i Prokurorisë së Posaçme vjen në kundërshtim me nenin 75/a të K.Pr.Penale dhe me nenin 3, të ligjit Nr.95/2016. Ky vendim nuk bazohet as në prova dhe në fakte, të cilat megjithëse janë të dukshme, konkrete dhe të pakontestueshme, përmes një qëndrimi dhe arsytimi absurd janë anashkaluar. Sipas palës ankuese, ndryshe nga sa pretendon drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në kallëzimin penal dhe në provat që kanë paraqitur kallëzuesit, mes të cilëve edhe viktima e veprës penale Rajmonda Nika, autorët e veprës penale të vrasjes së shtetasit Aleks Nika janë të identifikuar me emër, mbiemër, funksion dhe me rol në kuadër të organizatës kriminale për ekzekutimin e të ndjerit Aleks Nika dhe të personave të tjerë protestues të protestës kundërqeveritare të 21 janar 2011.

6. Pala ankuese shprehet se në kallëzimin penal theksohet se organizata kriminale që ekzekutoi shtetasit Aleks Nika, Ziver Veizi, Hekuran Deda dhe Faik Myrtaj, e plagosi me armë zjarri një numër të konsiderueshëm personash të tjerë, kryesohej nga ish - kryeministri Sali Berisha dhe ish - ministri i brendshëm Lulzim Basha si organizator, frymëzues dhe urdhërues. Kjo organizatë kriminale kishte si ekzekutor, zbatues të urdhrave për vrasje, shtetasit Ndrea Prendi, Agim Llupo, Alfred Ahmetcenaj, Artan Hoxha, Dashamir...etj. Sipas palës ankuese në kallëzimin penal evidentohen të gjitha provat direkte dhe indirekte që identifikojnë qartë dhe pa më të voglin ekuivok të gjithë organizatën kriminale. Pra, nuk është e vërtetë sa pretendohet prej drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në vendimin e tij Nr.K.137/1Prot.A.Sh., datë 24.02.2023, se nuk rezulton të jenë identifikuar autorë të veprës penale dhe si rrjedhim nuk është arritur të provohet se autorë mund të jenë subjekte të posaçme. Vendimi Nr.K. 137/1Prot.A.Sh., datë 24.02.2023, vjen në kundërshtim të hapur me provat, sikurse janë deklarimet e vetë “kokës së organizatës kriminale”, ish- kryeministrit Sali Berisha, i cili me

gojën e tij, me figurë, botërisht ka pranuar gjithë skemën e organizimit të organizatës kriminale, të pozicionimit të secilit prej anëtarëve të saj, të urdhrave që u dhanë. Në vijim të kërkesës ankimore, pala ankuese shprehet se vendimi Nr.K. 137/1 Prot.A.Sh., datë 24.02.2023, i Prokurorisë së Posaçme, vjen në kundërshtim flagrant me provat direkte dhe indirekte, duke filluar me alibitë e ish - kryeministrit Sali Berisha për të fshehur veprimet e organizatës kriminale se vrasjet u bënë gjoja nga vet protestuesit, me zhdukjen e serverave të kryeministrit me urdhër të ish - kryeministrit, me urdhërin që ky i fundit, i dha Policisë së Shtetit – zinxhirit drejtues të saj - për të mos ekzekutuar urdhërat e prokurorit për ndalimin e gardistëve të dyshuar për vrasjen e katër protestuesve dhe për plagosjet e realizuara me datë 21 janar 2011, me alibinë e tij se këto vrasje u bënë për shkak të një grushti shteti që organizoi kundër tij si kryeministër - ish presidenti i Republikës, ish - prokurorja e përgjithshme dhe ish - kreu i opozitës shqiptare etj.

7. Pala ankuese parashtron se provë e rëndësishme që vërteton se urdhëruesi i këtyre vrasjeve ishte pikërisht ish - kryeministri Sali Berisha - është fakti se komandanti i gardës, është thirrur ditën e ngjarjes në zyrën e këtij të fundit për të marrë urdhrin e ekzekutimit të disa prej protestuesve dhe bëri me të një debat të ashpër, i cili degjeneroi në ushtrimin e dhunës së rëndë fizike që ish kryeministri ushtroi mbi komandantin e gardës - shtetasin Ndre Prendi. Ky i fundit veprroi menjëherë me zinxhirin e anëtarëve të tjerë të organizatës kriminale dhe me armët e zjarrit të gardës bëri masakrën shtetërore, duke vrarë 4 qytetarë të këtij vendi dhe duke plagosur dhjetëra të tjerë. Videopërgjimi i ditës së ngjarjes, i cili nuk është marrë dhe as nuk është administruar prej drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme para se të merrte vendimin për të shpallur moskompetencën lëndore, është një provë shumë e rëndësishme, e cila e bën kompetente vetëm SPAK për regjistrimin e këtij procedimi penal dhe hetimin e kësaj çështje. Në vijim të kërkesës ankimore të paraqitur nga shtetasja Rajmonda Nika, citohen biseda që sipas palës ankuese ndodhen në videopërgjimin e datës 21.01.2011. Kështu, në komunikimin e parë realizohet kjo bisedë:

Ndre Prendi: Alfred dëgjon?

Alfred Ahmetcenaj: Po dëgjoj.

Ndre Prendi: Po afrohen shumë, duhet të jeni gati për zjarr.

Alfred Ahmetcenaj: Po të kuptova drejt.

Në bisedën e dytë:

Ndre Prendi: Të mbahen armët në dorë gati për zjarr. Të mbahen armët në dorë gati për zjarr në ajër. Pastaj kur të them unë në trup.

Ndre Prendi: Artan dëgjon? Artan dëgjon?

Artan Hoxha: Dëgjoj, dëgjoj.

Në bisedën e tretë:

Ndre Prendi: Me të kaluar gardhi i telave do hapet zjarr luftarak.

Artan Hoxha: Kuptova, kuptova

Ndre Prendi: Ky është urdhëri, Dashmir dëgjuat.

Dy efektiva të njësisë speciale: Alfred ta ta ta gjakos.

8. Pala ankuese parashtron se komunikimet (urdhrrat) janë dhënë vetëm me radio nga komandanti i gardës për vartësit e tij. Pasi është dhënë urdhër për të qëlluar, është zbatuar, duke realizuar të shtënat një nga një dhe me breshëri, nuk është dhënë më asnjë urdhër tjetër për të qëlluar. Nga komunikimi me radio, menjëherë pas vrasjeve të protestuesve, ka rënë qetësi absolute tek komandanti i gardës dhe oficerët drejtues me të cilët ai komunikon. Komunikimi në vijim është sikur nuk ka ndodhur asgjë, madje nuk përmendet në asnjë moment që ka të vrarë apo të plagosur.

I panjohur: 260 i Luanit, dëgjon?



260 i Luanit: Ju dëgjoj.

**Në bisedën e katërt:**

Audio: Menjëherë dëgjojen të shtëna tek e tek, sërish dëgjojen 8 të shtëna rradhazi një nga një.

Ndrea Prendi: Alfred?

Alfred Ahmetcenaj: Po dëgjoj (dëgjojen 2-3 të shtëna tek e tek).

Ndrea Prendi: Kujdes municionin! Kujdes municionin!

**Në bisedën e pestë**

Ndrea Prendi: Martin më dëgjon? Agim më dëgjon? Agim? Agim? 202 i Tufanit më 202 i Tufanit: Këtu jam. Ngjitur, ngjitur.

Ndrea Prendi: Alfred, një grup i njësisë speciale këtu tek porta numër 2.

Alfred Ahmetcenaj: Të kuptova.

Ndrea Prendi: Artan më dëgjon?

Artan Hoxha: Dëgjoj.

Ndrea Prendi: Le ta djegin pemën nuk ka problem.

I panjohur: 260 e Luanit?

I panjohur: Luani 3...

9. Pala ankuese shprehet se në këtë provë të rëndësishme - që duhet të merret, të administrohet dhe analizohet nga Prokuroria e Posaçme në tërësi bashkë me provat e tjera, del e qartë dhe pa ekuivoke se ka dyshime të arsyeshme, madje tej çdo dyshimi, se kemi të bëjmë me një organizatë të mirëfilltë kriminale të krijuar për të bërë vrasje politike, e cila parashikohet si veprë penale e rëndë, në nenin 333 të Kodit Penal, ndërsa vrasjet dhe plagosjet janë kryer nga kjo organizatë kriminale, veprë penale kjo e parashikuar nga neni 334 i këtij Kodi. Nga ana tjetër, me ndryshimet e bëra, është parashikuar ngritja e Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila gjykon veprat penale të korrupsionit dhe kimit të organizuar si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj dhe akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës. Sipas palës ankuese duke qenë se kallëzimi penal është bërë kundër ish - kryeministrit dhe deputetit të sotëm Sali Berisha, kundër ish - ministrit të brendshëm dhe deputetit të sotëm Lulzim Basha, kur në kallëzim penal evidentohen prova, fakte dhe dyshime të arsyeshme se jemi para një organizate kriminale, kompetencën lëndore për hetimin e kësaj çështje nuk e ka Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, por Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Si rrjedhojë, pala ankuese pretendon se Prokuroria e Posaçme duhet të regjistrojë procedimin penal dhe të nisë hetimet, duke i kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për të bërë pjesë përbërëse të këtij procedimi penal dosjen përkatëse që ajo prokurori disponon lidhur me këtë krim të rëndë shtetëror të 21 janarit 2011. Në përfundim të kërkesës ankimore, pala ankuese kërkon që në bazë të nenit 75/a të KPP dhe nenit 3, të ligjit Nr.95/2016, të priset vendimi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Nr.K.137/1Prot.A.Sh., datë 24.02.2023 dhe të urdhërohet Prokuroria e Posaçme për të regjistruar procedimin penal dhe për të hetuar çështjen penale, të kallëzuar nga viktimat e kimit, ndaj të kallëzuarve Sali Berisha (ish - kryeministër i RSH, në rolin e organizatorit), Lulzim Basha (ish - ministër i Punëve të Brendshme, në rolin e organizatorit) dhe Andrea Prendi (ish - komandant i Gardës së Republikës) etj. si organ i vetëm që ka kompetencë lëndore.

10. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nëpërmjet parashtrimeve të paraqitura pretendon se në Prokurorinë e Posaçme nuk është regjistruar ndonjë kallëzim penal me Nr.K137, i vitit 2023, por ky numër i përket numrit të protokollit hyrës në sekretarinë e prokurorisë të kallëzimit të shtetasës Rajmonda Nika dhe shtetasve të tjerë, ku data e hyrjes në sekretari është data 16.02.2023. Shkresa Nr. K137/1.Prot.A/SH., datë 24.02.2023 (që është shkresa për njoftim përfaqësuesit të kallëzuesve) dhe Nr. K137/2.Prot.A/SH., datë 24.02.2023 (që është shkresa me të cilën është dërguar për kompetencë lëndore kallëzimi penal Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë), të nënshkuara nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në vetvete janë shkresa administrative dhe nuk janë vendim moskompetencë lëndore, si dhe ankuesja kurrsesi nuk mund të ankimojë këto shkresa, pasi ajo nuk legjitimohet për të bërë ankim. Vetë Kodi i Procedurës Penale nuk ka parashikuar ndonjë rast ankimi për shkresat administrative të hartuara nga organi i prokurorisë, por vetëm për vendimmarrjet e prokurorit. Në vijim, Prokuroria e Posaçme shprehet se në bazë të neneve 28, 29, 84 dhe 89 të Kodit të Procedurës Penale vlerësimi që bën drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për kompetencën lëndore prevalon mbi vlerësimet e prokurorëve të prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm. Dërgimi i akteve të kallëzimit penal për verifikimin për kompetencë lëndore Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ndërkohë që nga kjo prokurori e juridiksionit të përgjithshëm po zhvilloheshin hetime për ngjarjen me të cilën kishin lidhje faktet e pretenduara nga kallëzuesit, kurrsesi nuk ka cenuar të drejtën e kallëzuesve për një proces të rregullt ligjor. Do të jetë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila, pas verifikimeve që do të kryejë në lidhje me kallëzimin e kallëzuesve do të vendosë me një vendimmarrje. Në varësi të vendimmarrjes, kallëzuesit mund të shfrytëzojnë çdo mjet ligjor për të ankimuar në rrugë gjyqësore këto vendimmarrje nëse do e shikojnë të arsyeshme. Për këto arsye, Prokuroria e Posaçme ka kërkuar rrëzimin e kërkesës së kërkuases Rajmonda Nika, si të pabazuar në ligj dhe në prova.

11. **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë), - gjyqtari për hetimet paraprake pranë saj - me vendimin nr. 107, datë 29.03.2023,** ka vendosur: “Mospranimin e ankimit...”.

12. **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë,** ndër të tjera, ka arsyetuar se, ... Organi i prokurorisë në përmbushje të një prej funksioneve kryesore të tij në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale në emër të shtetit, krahas funksionit të përfaqësimit të akuzës publike në gjyq në rastin e ngritjes së akuzës, përbën organin qendror kompetent të fazës së hetimit paraprak. Faza e hetimeve paraprake, si faza e parë e procedimit penal, përbën një fazë tepër të rëndësishme dhe thelbësore, që determinon suksesin e ushtrimit të ndjekjes penale në emër të shtetit në fazat e mëvonshme të procedimit, pasi në këtë fazë zhvillohen një sërë veprimesh të rëndësishme procedurale si: fillimi i procedimit penal, marrja e provave, marrja e të dhënave dhe provave me qëllim individualizimin e veprës penale, kualifikimin ligjor të saj dhe përcaktimin e autorit dhe rolit të tij në kryerjen e veprës penale, caktimi i masave të sigurimit, etj., për të përfunduar me ngritjen dhe njoftimin e akuzës, për të kaluar më pas në fazën e paraqitjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, në rast se konkludohet se vepra penale ka ndodhur dhe ka prova të mjaftueshme për t'ia atribuuar atë personit/personave të identifikuar si autore të veprës penale për të cilën procedohet në çdo rast. Ligji procedural penal parashikon në mënyrë të detajuar të gjitha fazat në të cilat zhvillohet hetimi paraprak, me qëllimin final të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm në funksion të zbulimit të së vërtetës dhe vënies para përgjegjësisë të personave që dyshohen si autorë të veprave penale. Në funksion të këtij qëllimi, që prokurori të ngrejë akuzë kundër personave përgjegjës për kryerjen e një vepre penale, ai duhet të zhvillojë një hetim të thelluar dhe të mbledhë fakte dhe prova me anë të të cilave, në tërësinë e tyre, të mund të arrijë të provojë para gjykatës fajësinë e personit që akuzohet. Në respektim të parimit të ligjshmërisë si dhe të elementeve të parimit të procesit të rregullt ligjor, prokuroria është e detyruar të hetojë me hollësi dhe të mbledhë prova, nëse ka,

kundër çdo të dyshuari. Nga ana tjetër ligji procedural, duke i njohur prokurorit të drejtën për të filluar procedimin penal, ka parashikuar disa kushte minimale që duhet të ekzistojnë, të afta për të ofruar të dhëna bazë mbi ekzistencën e faktit penal të referuar/kallëzuar, për të përligjur, në këtë mënyrë, në zbatim edhe të parimit të oportunitetit, nëse ka vend ose jo për fillimin e procedimit penal.

12.1 Me qëllim garantimin e zhvillimit të fazës fillestare të procedimit penal (hetimit paraprak) në respektim të ligjit procedural penal si dhe për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të individëve ndaj të cilëve ngrihet akuza ose janë dëmtuar si pasojë e veprës penale, ligjvënësi ka parashikuar në disa dispozita të KPP të drejtën e palëve në proces që për çdo veprim që ata vlerësojnë se cenon të drejtat dhe liritë e tyre t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës. Kështu, në nenin 278/1 të KPP parashikohet se: *"Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara në ligj, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata"*. Roli i gjykatës në fazën e hetimit paraprak paraqitet thelbësor pasi një sërë veprimesh që konsistojnë në marrjen e provave gjatë kësaj faze apo veprimet që afektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duhet të kalojnë patjetër nën vlerësimin e gjykatës. Por, nga ana tjetër roli i gjykatës në këtë fazë paraqitet thelbësor edhe në drejtim të shqyrtimit të kërkesave të subjekteve të tjera të procedimit (i pandehuri, viktimja ose palët private), duke garantuar në këtë mënyrë shqyrtimin e kërkesave të tyre nga një organ që ofron garancitë e mjaftueshme në drejtim të paanësisë. Pra, në këtë mënyrë, parashikohen mekanizma ligjore efektive për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë procedimit penal si dhe për të kontrolluar, nëpërmjet mjeteve ligjore përkatëse, ligjshmërinë e veprimtarisë hetimore të prokurorit. Në këtë drejtim, gjykata shqyrton kërkesat/ankimet e subjekteve ndaj veprimeve të prokurorisë, në ato raste kur ligji procedural në mënyrë të shprehur parashikon ankimin ndaj tyre në gjykatë.

12.2 Aktualisht kontrolli gjyqësor mbi ligjshmërinë e vendimmarrjes së prokurorit në fazën e hetimeve paraprake, krahas gjykatës që gjykon çështjen në themel, në rastin kur ngrihet akuzë, realizohet edhe nëpërmjet gjyqtarit të hetimit paraprak i cili shqyrton ankimin e subjekteve të legjitimuara ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal sipas parashikimeve të nenit 291 të KPP, si dhe nëpërmjet gjyqtarit të seancës paraprake.

12.3 Në ligjin e posaçëm që rregullon organizimin dhe funksionin e prokurorisë, në një sërë dispozitash parashikohen parimet mbi të cilat funksionon ky organ kushtetues. Konkretisht në ligjin Nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 4 parashikohet se: *"1. Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi. 2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik."*, ndërsa në nenin 6/1 parashikohet se: *"1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashitjnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë."* Lidhur me detyrueshmërinë e ushtrimit të ndjekjes penale, në nenin 5 të këtij ligji parashikohet se: *"Ushtrimi i ndjekjes penale është i detyrueshëm, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe."* Funksionet e prokurorit, duke veçuar veprimet fillestare të tij që lidhen me marrjen e dëgjimit për veprën penale dhe vendimmarrjen për regjistrimin e procedimit penal, parashikohen shprehimisht në nenet 24 dhe 280 të KPP, nga përmbajtja e të cilave rezulton se ushtrimi i ndjekjes penale ndaj çdo personi, mbi ankimin e viktimës kur ai është i nevojshëm sipas parashikimeve të nenit 284 të KPP apo kryesisht, për veprat e tjera penale, përbën detyrim ligjor dhe kushtetues për organin e prokurorisë, në rast se vlerësohet se ka të dhëna bazë për ekzistencën e një fakti penal. Kjo veprimtari e prokurorit lidhur me vlerësimin nëse ka ose jo të dhëna të mjaftueshme për regjistrimin e procedimit penal, për shkak të rëndësisë që mbart dhe pasojave që mund të sjellë mbi interesin publik apo të drejtat e personave të dëmtuar, është



parashikuar nga ligjvënësi si një vendimmarrje e cila i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Në referim të parashikimeve të neneve 290 dhe 291 të KPP, ky kontroll realizohet mbi: (i) ligjshmërinë e vendimit të mos fillimit të procedimit penal dhe bazueshmërinë e tij në shkaqet e parashikuara nga ligji procedural penal të cilat nuk lejojnë fillimin e procedimit penal dhe (ii) bazueshmërinë e shkaqeve të ngritura në ankimin ndaj vendimit të mos fillimit të procedimit penal.

12.4 Përsa i përket rolit të gjykatës në kontrollin mbi vendimin për mosfillimin e procedimit penal, pushimit të procedimit penal në rastet kur procedohet për kundërvajtje penale apo gjatë shqyrtimit të kërkesës për pushimin e procedimit penal kur procedohet për krime, në vendimin unifikues Nr.2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera arsyetohet se: *"22. Nën dritën e arsytimit të mësipërm, vendimi i prokurorit që ka disponuar mos fillimin e procedimit penal, merret mbasi më parë, janë verifikuar rrethanat e parashikuara nga neni 290 i KPP. Këto rrethana, në fakt, nuk kërkojnë një proces të ndërlikuar e të gjatë për mbledhjen e të dhënave apo të kryerjes së veprimeve të rëndësishme hetimore në drejtim të zbulimit të fakteve lidhur me themelin e fajësisë apo të pafajësisë. Në këtë kuadër, gjykimi i ankimit kundër vendimit të prokurorit për mos fillim nuk kërkon një shqyrtim gjyqësor të ndërlikuar dhe, për rrjedhojë, ai mund të bëhet edhe vetëm mbi bazë shqyrtimi të dokumenteve (de plano) .... Për sa më sipër, arrihet në konkluzionin se: Në gjykimin e çështjes me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes penale, gjykata shqyrton, jo vetëm bazueshmërinë e kërtimeve të paraqitura nga ana e ankuesit, por edhe kontrollin e ligjshmërisë së këtij vendimi, duke verifikuar nëse nga ana e prokurorit janë respektuar drejt rastet e parashikuara nga ligji lidhur me pushimin e çështjes penale. Kur vendos shfuqizimin e vendimit, gjykata ka të drejtë të disponojë mbi kryerjen e veprimeve të tjera që kanë lidhje me akuzën dhe me veprimet hetimore të kryera deri në atë çast, në funksion të zbulimit të fakteve dhe të vërtetës për ushtrimin e ndjekjes penale sipas ligjit. Referuar rolit të gjykatës në sistemin akuzator, ku mbizotëron funksioni i dhënies së drejtësisë nëpërmjet luajtjes së rolit të saj si një arbitër, do të përbënte një tejkalim të këtij funksioni fakti që, krahas shfuqizimit të vendimit të pushimit, të ekzistonte prerogativa e gjykatës për disponimin, dhe dërgimin e çështjes në gjyq apo ngritjen e akuzave të reja nga ana e saj. Në bazë të ligjit procedural penal, gjykata nuk mund të urdhërojë formulimin e akuzave të reja gjatë fazës së hetimeve paraprake apo në përfundim të saj. Ajo gjykon akuzën e ngritur nga ana e prokurorit gjatë gjykimin në themel të saj, duke vendosur nëse qëndron ose jo akuza e ngritur. Në këto kushte, i vetmi disponim që mund të ketë gjykata, mbetet ai për shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes, meqenëse nuk ka se çfarë veprimesh të tjera hetimore të kryhen, ndaj në këtë rast, gjykata duhet të konstatojë vetëm paligjshmërinë e vendimit të pushimit të prokurorit."* Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se vendimi i pushimit dhe mosfillimit të prokurorit mund të cenohet jo vetëm për mungesë të një hetimi dhe vlerësimi të plotë dhe të gjithanshëm lidhur me faktet objekt kallëzimi, por edhe kur konstatohet se prokurori, në interpretim të gabuar të ligjit material që parashikon elementët e figurës së veprën penale konkrete, arrin në përfundimin se nuk ka veprën penale, ndërkohë që nga faktet e mbledhura rezultojnë të dhëna të besueshme se fakti penal ekziston dhe për pasojë, nuk janë prezent shkaqet e mos fillimit apo pushimit të procedimit penal sipas parashikimeve të nenit 290 dhe 328 të KPP.

12.5 Në rastin konkret, Gjykata çmon se nëpërmjet kërkesës ankimore të paraqitur, shtetasja Rajmonda Nika kundërshton shkresën e nxjerrë nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Konkretisht, ashtu siç është cituar edhe më lart, rezulton se me datë 16.02.2023, nga shtetasit Mahmude Myrtaj, Rinaldo Myrtaj, Rajmonda Nika, Caush Veizi, Zabit Deda, Ilvi Deda, Trandafile Muhameti dhe Ana Veizi është paraqitur pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar një kallëzim penal. Të kallëzuar nëpërmjet këtij kallëzimi penal janë shtetasit Sali Berisha (ish - kryeministër i RSH, në rolin e organizatorit), Lulzim Basha (ish - ministër i Punëve të Brendshme, në rolin e organizatorit), Andrea Prendi

(ish - komandant i Gardës së Republikës, në rolin e organizatorit, nxitësit dhe ekzekutorit) si dhe ndaj shtetasit Agim Llupo (në rolin e ekzekutorit). Këta shtetas janë kallëzuar për kryerjen e veprës penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", kundër dy ose më shumë personave, e kryer në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, vepër që parashikohet nga nenet 79-28 të Kodit Penal. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nëpërmjet shkresës me Nr.K.137/1.Prot.A/SH., datë 24.02.2023, e ka dërguar këtë material kallëzues për kompetencë lëndore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Në shkresën e mësipërme drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka cituar se - nga verifikimi i bërë në sektorin e protokoll/arkivës së Prokurorisë së Posaçme evidentohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka regjistruar procedimin penal Nr.285, datë 21.01.2011, për veprën penale të "Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese", të parashikuar nga neni 79, germa "dh" dhe "ë" të Kodit Penal. Me datë 02.04.2021, për këtë procedim penal kanë rifilluar hetimet e pezulluara me qëllim identifikimin e autorëve të vrasjes së shtetasve Aleks Nika dhe Hekuran Deda si dhe plagosjen e disa shtetasve të tjerë Gjithashtu, nga informacioni që Prokuroria e Posaçme ka marrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë rezulton se nuk kishte të regjistruar emra të personave që i atribuohet vepra penale. Në vijim drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme shprehet se nga përmbajtja e materialit kallëzues dhe verifikimi i kryer (pavarësisht se kallëzimi penal është depozituar në Prokurorinë e Posaçme duke u kallëzuar subjekte të posaçme për kryerje veprash penale në kuadër të një organizate kriminale) evidentohet e dhëna se në lidhje me objektin e kallëzimit penal dhe faktet e pretenduara - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë - po kryen hetime në kuadër të procedimit penal Nr.285/2011 për vepra penale që nuk janë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme. Gjithashtu, deri në këto momente të hetimit, që po kryhet nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nuk rezulton të jenë identifikuar autorë të veprës penale dhe si rrjedhojë nuk është arritur të provohet se autorë mund të jenë subjekte të posaçme sipas përcaktimeve të nenit 75/a të K.Pr.Penale dhe nenit 3, të ligjit Nr.95/2016. Në këto kushte, bazuar në nenet 75/a, 28, 76, të KPP është vlerësuar se kallëzimi penal duhet të përcillet për kompetencë lëndore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me qëllim vlerësimin nga ana e kësaj prokurorie. Në përfundim të shkresës objekt ankimi është cituar se "nëse në vijim të verifikimeve apo hetimeve do të konstatohet ekzistenca e ndonjë vepre penale apo subjekt në kompetencë hetimi, sipas nenit 75/a të K.Pr.Penale, atëherë aktet e procedimit penal të dërgohen për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Posaçme, referuar edhe nenit 28 të K.Pr.Penale". Shtetasja Rajmonda Nika, duke mos qenë dakord me këtë shkresë të nxjerrë nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka paraqitur kërkesën objekt gjykimi. Shtetasja Rajmonda Nika në thelb pretendon se shkresa e mësipërme është vendim për shpallje moskompetencë lëndore dhe se ky vendim duhet të prishet dhe të urdhërohet Prokuroria e Posaçme që të regjistrojë procedimin penal dhe të hetojë çështjen në ngarkim të të akuzuarve prej kallëzuesve.

12.6 Gjykata vlerëson se nuk rezulton që të jemi para një vendimmarrje apo shprehje të vullnetit, të materializuar në aktin objekt ankimi nga shtetasja Rajmonda Nika, për mosushtrimin e ndjekjes penale. Kjo pasi rezulton e qartë se në shkresën e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme është bërë vlerësimi paraprak i të dhënave objekt kallëzimi. Pra, në rastin konkret, shkresa/akti objekt ankimi në këtë gjykim nuk përmban asnjë të dhënë apo element që mund të vlerësohet në drejtim të kontrollit mbi vullnetin apo mungesën e vullnetit të Prokurorisë së Posaçme për ushtrimin e ndjekjes penale. Si rrjedhojë, ankimi i ushtruar nga shtetasja Rajmonda Nika në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë së këtij akti të drejtuesit të Prokurorisë, nuk mund të elaborohet në drejtim të vullnetit të organit procedues për ushtrimin e ndjekjes penale mbi faktet objekt kallëzimi. Arrihet në këtë konkluzion, për sa kohë që nuk jemi para një vendimmarrje të këtij organi për mos ushtrimin e ndjekjes penale, vendimmarrje e cila, sipas parashikimeve të neneve 290 dhe 291 të K.Pr.Penale, është në kompetencë të

gjykatës, duke qenë se ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht ankim pranë kësaj të fundit. Referuar sa më sipër, Gjykata vlerëson se rastet në të cilat palët e interesuara mund të ankimojnë në gjykatë vendimmarrjen e prokurorit gjatë fazës së hetimit paraprak, janë të përcaktuara shprehimisht nga ligjvënësi. Konkretisht ligjvënësi ka përcaktuar subjektet e legjitimuara, vendimmarrjen objekt ankimi, shkaqet ligjore mbi të cilat duhet të mbështetet ankimi, si dhe gjykatën/gjyqtarin kompetent për shqyrtimin e tyre.

12.7 Përsa i përket disponimit për dërgimin e materialeve kallëzuese për kompetencë lëndore në prokurorinë kompetente, referuar ligjit procedural penal, nuk rezulton në asnjë rast që ligjvënësi të ketë parashikuar ankimin e këtij disponimi/vendimmarrje në gjykatë. Në lidhje me çështje të kompetencës lëndore, e cila për shkak të rëndësisë thelbësore që mbart, si parakusht që përcakton edhe ligjshmërinë e ushtrimit të ndjekjes penale nga prokuroria apo ligjshmërinë e shqyrtimit të çështjes nga gjykata, ligjvënësi ka parashikuar shqyrtimin edhe vlerësimin edhe kryesisht nga organi procedues, në çdo fazë dhe shkallë të procedimit. Për shkak të rëndësisë së posaçme që paraqet kompetenca lëndore si në fazën e hetimit ashtu edhe në atë të gjykimit, përveç shqyrtimit të kërkesave të palëve lidhur me këtë aspekt, ligjvënësi ka përcaktuar detyrimin e organit procedues, për ta vlerësuar dhe shqyrtuar çështjen e kompetencës lëndore si parakusht për ligjshmërinë e procedimit, pavarësisht nëse subjektet e procedimit paraqesin ose jo kundërshtime lidhur me kompetencën lëndore të organit procedues. Pikërisht për shkak të rëndësisë dhe pasojave që sjell mosrespektimi i dispozitave mbi kompetencën lëndore në K.Pr.Penale është parashikuar se mund të ngrihet kryesisht nga gjykata në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit. Kështu, sipas nenit 83/1 të K.Pr.Penale, parashikohet se *"Moskompetenca kompetenca lëndore ngrihet edhe kryesisht, në çdo gjendje e shkallë të procesit."* Sa i përket mosmarrëveshjeve të kompetencës midis dy gjykatave, në nenin 89 të KPP, parashikohet se: *"1. Ka mosmarrëveshje, në çdo gjendje a shkallë të procedimit, kur dy a më shumë gjykata në të njëjtën kohë marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën akuzë, që i atribuohet të njëjtit person"*. Konflikti për kompetencën ekziston atëherë kur dy ose më shumë gjykata konsiderojnë se kanë kompetencë lëndore apo tokësore dhe në të kundërtën, kur konsiderojnë se u mungon kompetenca për të vendosur lidhur me një çështje penale. Në rastin e mosmarrëveshjeve të kompetencës midis dy gjykatave, ligjvënësi ka parashikuar si mjet për zgjidhjen e saj, parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencës para Gjykatës së Lartë, duke parashikuar në nenin 90 të K.Pr.Penale se: *"1. Mosmarrëveshja mund të parashtrohet nga prokurori pranë njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i pandehuri dhe palët private. Parashtrimi paraqitet në sekretarinë e njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje, me kërkesë të shkruar e të motivuar, të cilës i bashkohet dokumentacioni i nevojshëm. 2. Gjykata që ngre çështjen e mosmarrëveshjes merr vendim, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj, duke treguar palët dhe mbrojtësit. 3. Gjykata që ka dhënë vendimin, njofton menjëherë gjykatën në mosmarrëveshje"*. Pra, në rastin e mosmarrëveshjes për kompetencë midis dy gjykatave, kjo mosmarrëveshje nuk zgjidhet me ankim të palëve, por ngrihet nga gjykata respektive, nëpërmjet një mjeti të posaçëm procedural që është ngritja e mosmarrëveshjes për kompetencë pranë Gjykatës së Lartë.

12.8 Në të njëjtën mënyrë, lidhur me çështje të kompetencës lëndore ose tokësore të prokurorisë, ligjvënësi ka parashikuar mjete të posaçme për vlerësimin e saj apo zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes dy prokurorive. Ky aspekt rregullohet që në momentin fillestar të paraqitjes së një materiali që potencialisht mund të shërbejë si shkak për fillimin e procedimit penal, apo edhe kur vlerësimi lidhur me kompetencën lind gjatë procedimit penal në fazën e hetimit paraprak. Kështu, në nenin 28 të K.Pr.Penale parashikohet se: *"1. Kur gjatë hetimeve paraprake prokurori çmon se vepra penale është në kompetencën e një gjykate të ndryshme nga ajo pranë së cilës ushtron funksionet e tij, ia kalon menjëherë aktet prokurorisë pranë gjykatës kompetente. 2. Prokurori që ka marrë aktet, në qoftë se çmon se duhet të procedojë*

prokuroria që i ka dërguar aktet, njofton Prokurorin e Përgjithshëm, i cili, pasi shqyrton aktet, cakton se cila prokurori duhet të procedojë dhe njofton prokuroritë e interesuara. 3. Nëse prokurori çmon se vepra penale është në kompetencën e Prokurorisë së Posaçme ose merr dijeni se pranë kësaj prokurorie po zhvillohen hetime për të njëjtin fakt dhe në ngarkim të të njëjtit person, ia kalon aktet Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili, pasi i shqyrton ato, vendos pranimin e akteve ose i ridërgon ato në prokurorinë e mëparshme. Kjo e fundit ka detyrimin të pranojë aktet." Ndërsa, në nenin 29 të KPP parashikohet se: "1. Kur prokurori merr dijeni se pranë një prokurorie tjetër janë duke u zhvilluar hetime paraprake në ngarkim të të njëjtit person dhe për të njëjtin fakt, në lidhje me të cilin ai procedon, njofton pa vonesë atë prokurori, duke i kërkuar dërgimin e akteve. 2. Prokurori që ka marrë kërkesën, kur nuk është dakord me të, informon Prokurorin e Përgjithshëm, i cili pasi të ketë marrë të dhënat e nevojshme, vendos, sipas rregullave, mbi kompetencën e gjykatës se cila prokurori duhet të procedojë dhe njofton prokuroritë e interesuara. Prokurorisë së caktuar i dërgohen menjëherë aktet nga prokuroria tjetër. 3. Nëse prokurori i Prokurorisë së Posaçme merr dijeni se pranë një prokurorie janë duke u zhvilluar hetime paraprake në ngarkim të të njëjtit person dhe për të njëjtin fakt, në lidhje me të cilin ai procedon, njofton pa vonesë drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, i cili vendos, sipas rregullave mbi kompetencën, se cila prokurori duhet të procedojë. Në rast se ai vendos që kompetenca i takon Prokurorisë së Posaçme, njofton prokurorinë e caktuar, e cila duhet t'i dërgojë aktet". Nga përmbajtja e këtyre dispozitave rezultojnë se çështjet e kompetencës midis prokurorive, gjatë fazës së hetimit paraprak, zgjidhen nëpërmjet parashtrimit të konfliktit para Prokurorit të Përgjithshëm. Ky i fundit vlerëson dhe vendos se cila prokurori duhet të procedojë, referuar dispozitave mbi kompetencën lëndore dhe/ose tokësore të gjykatës pranë së cilës secila prokurori "në konflikt" ushtron funksionet e saj.

12.9 Në rastin e çështjeve lidhur me kompetencën lëndore midis prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm me Prokurorinë e Posaçme, ligjvënësi ia ka njohur drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme autoritetin për të vlerësuar dhe vendosur mbi kompetencën lëndore. Një autoritet të tillë ai e ushtron nëpërmjet mekanizmit të pranimin të akteve ose ridërgimit të tyre pranë prokurorisë referuese, sipas parashikimeve të nenit 28/3 të KPP ose nëpërmjet kërimit për dërgimin e akteve nga prokuroria e juridiksionit të përgjithshëm, sipas parashikimeve të nenit 29/3 të K.Pr.Penale. Nëpërmjet këtyre dispozitave ligjvënësi ka përcaktuar se nëse ka qëndrime të ndryshme midis prokurorive lidhur me kompetencën, mendimi dhe qëndrimi i Prokurorisë së Posaçme prevalon dhe është i detyrueshëm për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Në të njëjtën logjikë ligjvënësi, në nenin 89/2 të K.Pr.Penale, lidhur me mosmarrëveshjet e kompetencës në fazën e hetimit paraprak parashikon se: "2 Mosmarrëveshjet në fazën e hetimit paraprak mes prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, zgjidhen nga prokurori më i lartë. Në rast konflikti gjatë hetimeve paraprake ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe një prokurorie tjetër, ka përparësi kompetenca dhe juridiksioni i së parës. Zbatohen parashikimet e neneve 28 dhe 29 të këtij Kodi. 3. Gjatë hetimeve paraprake nuk mund të parashtrohet mosmarrëveshja e bazuar në arsyet e kompetencës territoriale për shkak lidhjeje të procedimeve." Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezultojnë se mosmarrëveshjet e kompetencës lëndore në fazën e hetimit paraprak mes prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, zgjidhen nga prokurori më i lartë. Ndërsa, në rast konflikti mbi kompetencën midis Prokurorisë së Posaçme dhe një prokurorie tjetër të juridiksionit të përgjithshëm, ka përparësi kompetenca dhe juridiksioni i së parës dhe gjejnë zbatim parashikimet e neneve 28 dhe 29 të K.Pr.Penale. Sipas këtyre dispozitave, sikurse u referuar më sipër në këtë vendim, mendimi dhe qëndrimi i Prokurorisë së Posaçme prevalon dhe është i detyrueshëm për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

12.10 Nga tërësia e dispozitave të sipërcituara, rezultojnë se qëllimi i ligjvënësit për zgjidhjen e çështjes se kompetencës lëndore apo tokësore, në fazën e hetimit paraprak, ka qenë rregullimi nëpërmjet mekanizmave të posaçëm të cilët funksionojnë brenda sistemit të



prokurorisë. Në asnjë rast nuk parashikohet se kjo çështje mund të rregullohet nëpërmjet ankimit në gjykatë ndaj vendimmarrjes apo disponimit të prokurorit për shpalljen e moskompetencës në fazën e hetimit paraprak. Sa më sipër, Gjykata vlerëson se disponimi/vendimmarrja e Prokurorisë së Posaçme për dërgimin e materialeve kallëzuese për kompetencë lëndore sipas parashikimeve të neneve 28 e 75/a të K.Pr.Penale që përcakton kompetencën e gjykatës së posaçme, për pasojë edhe lëndën mbi të cilën mund të procedojë Prokuroria e Posaçme, nuk parashikohet nga ligjvënësi si një vendimmarrje e ankimueshme në rrugë gjyqësore. Mbështetur në analizën e mësipërme, Gjykata vlerëson se shkresa e kundërshtuar nëpërmjet kërkesës objekt gjykimi është shkresë përcjellëse e kallëzimit dhe si e tillë nga ana e legjislatorit nuk është parashikuar ankim në gjykatë. Pra, nuk rezulton që Prokuroria e Posaçme të ketë marrë një vendim, kundër të cilit ligji të ketë parashikuar ankim në Gjykatë. Aq më tepër nuk rezulton se është marrë një vendim për mosfillimin e procedimit penal sipas nenit 291 e vijues të K.Pr.Penale. Marrja e një vendimi të tillë do të legjitimonte viktimën apo edhe kallëzuesin që të depozitonte ankim në Gjykatë dhe si rrjedhojë të kërkonte prishjen e vendimit të mosfillimit dhe detyrimin e Prokurorisë së Posaçme që të regjistrojë procedim penal e të kryejë hetime në lidhje me kallëzimin e paraqitur. Gjykata çmon se në rastin objekt gjykimi shkresa e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme me Nr.K.137/1.Prot.A/SH., datë 24.02.2023, nuk përbën një vendim mosfillimi penal, qoftë nga pikëpamja e formës, e përmbajtjes apo të efekteve që ajo sjell, por përbën disponim të prokurorit, konform nenit 28 të K.Pr.Penale, për kalimin e akteve një prokurorie tjetër.

12.11 Gjykata çmon të theksojë se ankuesja ka të drejtë që, si në fazën e hetimit paraprak ashtu edhe në gjykim, nëse vlerëson se nga hetimi që kryhet nga prokuroria kompetente (prokuroria e juridiksionit të përgjithshëm pranë së cilës janë dërguar materialet kallëzuese) rezultojnë sipas saj elemente që japin të dhëna konkrete mbi fakte që përbejnë elemente të veprave penale që janë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatës së Posaçme, nëpërmjet mjeteve procedurale të duhura, ti drejtohet prokurorisë përkatëse duke kërkuar vlerësimin e pretendimeve të saj lidhur me kompetencën lëndore. Po ashtu, prokuroria e juridiksionit të përgjithshëm që ka marrë materialin kallëzues të dërguar për kompetencë, nëse gjatë hetimit konstaton dhe vlerëson se ka elemente të veprave penale që janë në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme, i ka të gjitha mjetet dhe mundësitë ligjore të vlerësojë dhe shpallë mos kompetencën lëndore në bazë të parashikimeve të neneve 84/1 dhe 75/a të K.Pr.Penale. Edhe pas përfundimit të fazës së hetimit paraprak, përsëri ankuesja ka mjetet ligjore të nevojshme për të parashtruar dhe kërkuar vlerësimin e pretendimeve të saj lidhur me kompetencën lëndore pasi në përfundim të hetimeve Prokuroria do të duhet t'i drejtohet gjyqtarit të seancës paraprake për kalimin e çështjes për gjykim ose për pushimin e saj. Në këtë proces ankuesja mund të kërkojë që të bëhet cilësimi juridik sipas pretendimeve të saj dhe për pasojë të vlerësohet edhe çështja e kompetencës lëndore. Nëse gjyqtari i seancës paraprake do ta çmojë të drejtë kërkesën e ankueses, mund të urdhërojë prokurorinë të korrigjojë akuzën sipas nenit 332/d/3 të KPP ku parashikohet se: "*3. Kur gjatë seancës paraprake del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar, ose kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos t'i kthejë aktet. Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë.*", dhe në përfundim të gjykimit, nëse do të konstatojë se fakti nuk është në kompetencën e saj lëndore por duhet të hetohet nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, bazuar në nenin 332/dh të KPP ku parashikohet se: "*1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos: ...; d) deklarimin e mos kompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente në rastet e parashikuara në ligj.*", mund të shpallë moskompetencën lëndore duke i dërguar aktet Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kjo e fundit pasi thërret prokurorinë në seancën

paraprake mund të disponojë me kthimin e akteve e të disponojë sipas cilësimit juridik që ajo e çmon të drejtë.

12.12 Siç është cituar edhe më sipër, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ligjvënësi, në nenin 28/3 të K.Pr.Penale, i ka njohur të drejtën të vendosë pranimin e akteve ose ridërgimin në prokurorinë e mëparshme, në rastin kur prokurori i një prokurorie tjetër i është drejtuar atij, pasi ka çmuar se vepra penale është në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme. Ndërsa, neni 29/3 i K.Pr.Penale, parashikon situatën kur prokurori pranë Prokurorisë së Posaçme merr dijeni se pranë një prokurorie janë duke u zhvilluar hetime paraprake në ngarkim të të njëjtit person dhe për të njëjtin fakt, në lidhje me të cilin ai procedon, ai njofton pa vonesë drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, i cili vendos, sipas rregullave mbi kompetencën, se cila prokurori duhet të procedojë. Bazuar në nenin 29 të K.Pr.Penale rezulton se nëse ka qëndrime të ndryshme midis prokurorive lidhur me kompetencën, mendimi dhe qëndrimi i Prokurorisë së Posaçme prevalon dhe është i detyrueshëm për prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Referuar neneve 83, 89 të KPP mosmarrëveshjet e kompetencës lëndore në fazën e hetimit paraprak mes prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm zgjidhen nga prokurori më i lartë. Në rastin konkret, siç është theksuar edhe më sipër rezulton se nga ana e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, është çmuar se kallëzimi penal i paraqitur me datë 16.02.2023, nuk është në kompetencën e saj dhe i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me shkresën me Nr.K.137/1.Prot.A/SH., datë 24.02.2023, objekt ankimi nga shtetasja Rajmonda Nika. Në rast se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë do të vlerësojë se nuk është kompetente për trajtimin e kallëzimit të përcjellë nga Prokuroria e Posaçme, nga ana e legjislatorit në nenet 28, 29, 83, 84 dhe 89 të KPP është parashikuar edhe mënyra sesi zgjidhet kjo situatë juridike. Shkresat e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, përbëjnë disponim të prokurorit konform nenit 28 të K.Pr.Penale për kalimin e akteve një prokurorie tjetër. Në situatën kur procedohet në fazën e hetimit për kalimin e akteve një prokurorie tjetër, sipas nenit 28 të K.Pr.Penale, ashtu edhe në rastin kur kërkohen aktet nga një prokurori tjetër sipas nenit 29 të K.Pr.Penale, nenet në fjalë, përfshirë edhe nenet 84/1 dhe 89/2 të K.Pr.Penale, nuk parashikojnë taksativisht të drejtën e kundërshtimit në gjykatë të vendimit të prokurorit "për kalimin e akteve një prokurorie tjetër", pra konstatimin e moskompetencës së vet. Në këto kushte, bazuar në nenet 28, 29, në lidhje me nenin 89/2 të K.Pr.Penale, Gjykata vlerëson se kjo vendimmarrje/disponim i drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme me shkresën me Nr.K.137/1.Prot.A/SH., datë 24.02.2023, është e paankimueshme në gjykatë. Ndodhur në situatën e mësipërme, Gjykata çmon se jemi në kushtet kur kërkesa ankimore e paraqitur nuk duhet pranuar në respektim të neneve 407/4 të KPP dhe 420/1/b të KPP. ...

12.13 Neni 407 i K.Pr.Penale ka parashikuar shprehimisht se: *"Ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit"*. Në rastin konkret, referuar nenit 89/2 të K.Pr.Penale, konstatohet se ndaj vendimit të prokurorit për kalimin e akteve për kompetencë një prokurorie tjetër, ligjvënësi nuk parashikon të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës/gjyqtarit të hetimit, për rrjedhojë ndaj vendimit të Gjykatës nuk njihet as e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit. Për këto arsye, Gjykata pasi ka marrë në analizë të gjitha faktet e mësipërme vlerëson se kërkesa ankimore e paraqitur është e pabazuar në ligj dhe si rrjedhojë nuk duhet të pranohet.

**13. Kundër vendimit të mësipërm, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, ka paraqitur ankim kallëzuesja/ankuesja Rajmonda Nika, duke kërkuar: "Prishjen e Vendimit të Gjykatës së Posaçme Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Nr.107, datë 29.03.2023 dhe urdhërimin e Prokurorisë së Posaçme Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të regjistruar procedimin penal dhe për të hetuar çështjen penale të kallëzuar nga viktimat e krimin të kallëzuarve Sali Berisha, ish Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, Lulzim Basha,**

*ish Ministër i Brendshëm dhe Ndrea Prendi ish Komandanti i Gardës së Republikës etj. si organi i vetëm që ka kompetencën lëndore.”*

**14. Gjykata e Posaçme e Apelit Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim Gjykata e Posaçme e Apelit), me vendimin nr. 92 (87-2023-136), datë 21.06.2023, ka vendosur: “Mospranimin e ankimit kundër vendimit nr. 107, datë 29.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”**

**15. Gjykata e Posaçme e Apelit**, ndër të tjera, ka arsyetuar se, ... shkresa Nr.K.137/1.Prot. A.SH., datë 24.02.2023, e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me lëndë "Dërgim materiali kallëzues Nr.K. 137/1. Prot, datë 16.02.2023, për kompetencë lëndore", në vetvete, përbën disponim të Prokurorit, konform nenit 28 të Kodit të Procedurës Penale, për kalimin e akteve një prokurorie tjetër. Konkretisht, Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, ligjvënësi, në nenin 28, pika 3, i ka njohur kompetencën të vendosë pranimin e akteve, ose ridërgimin në prokurorinë e mëparshme, në rastin kur prokurori pranë prokurorisë së juridiksionit të zakonshëm i është drejtuar atij, pasi ka çmuar se vepra penale është në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme. Ndërsa neni 29, pika 3, i Kodit të Procedurës Penale, parashikon situatën, kur prokurori pranë Prokurorisë së Posaçme merr dijeni se pranë një prokurorie janë duke u zhvilluar hetime paraprake në ngarkim të të njëjtit person dhe për të njëjtin fakt, në lidhje me cilin ai procedon, ai njofton pa vonesë drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, i cili vendos, sipas rregullave mbi kompetencën, se cila prokurori duhet të procedojë.

15.1 Në rastin konkret, me shkresën nr. K.137/1.Prot. A.SH., datë 24.02.2023, të Drejtuesit Prokurorisë së Posaçme, referuar nenit 28 të Kodit të Procedurës Penale, është përcjellë materiali kallëzues me nr. kallëzimi 137 prot, datë 16.02.2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, duke arsyetuar në përmbajtjen e kësaj shkrese, se .... Në këto rrethana, bazuar në nenet 75/a, 28, 76 të Kodit të Procedurës Penale, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, është vlerësuar se kallëzimi penal duhet të përcillet për kompetencë lëndore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me qëllim vlerësimin nga ana e kësaj prokurorie.

15.2 Mbështetur sa më sipër, Gjykata e Posaçme e Apelit, e gjen të drejtë arsyetimin dhe konkluzionin e arritur nga ana e Gjykatës së Posaçme të shkallës së parë se, në rastin konkret, nuk jemi para një vendimmarrje të Prokurorisë së Posaçme për mosushtrimin e ndjekjes penale (vendim mosfillimi apo pushimi të procedimit penal në rastet kur procedohet për kundërvajtje penale), vendimmarrje e cila mund të jetë e ankimueshme në gjykatë.

15.3 Gjykata e Posaçme e Apelit, ashtu si Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë), vlerëson se disponimi i drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me aktin nr.K137/1.Prot. A.SH., datë 24.02.2023, me lëndë "Dërgim materiali kallëzues Nr.K. 137/1.Prot, datë 16.02.2023 për kompetencë lëndore", nuk përbën një vendim mosfillimi apo pushimi të çështjes penale (kur procedohet për kundërvajtje penale) pasi fakti objekt kallëzimi po hetohet dhe në përfundim të hetimeve i vetmi autoritet që ka kompetencë (për krime) të pushojë çështjen penale është gjyqtari i seancës paraprake, sipas nenit 329 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

15.4 Në të tilla rrethana, Gjykata e Posaçme e Apelit, konstaton se në shqyrtimin e kësaj çështje duhet të shqyrtohet kryesisht çështja e pranueshmërisë për gjykim të ankimit të paraqitur prej kallëzueses/ankueses Rajmonda Nika ndaj disponimit të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme me aktin nr.K.137/1.Prot. A.SH., datë 24.02.2023, me lëndë "Dërgim materiali kallëzues Nr K. 137/1.Prot, datë 16.02.2023, për kompetencë lëndore" për kallëzimin penal nr. 137 prot., datë 16.02.2023.

15.5 Pranueshmëria për gjykim e ankimit përbën një prezumim procedural për ekzistencën e një procesi gjyqësor rishikues dhe në kushtet e verifikimit të një shkakut papranueshmërie apo

paprocedueshmërie, atëherë procesi gjyqësor nuk fillon dhe nëse ka filluar shuhet. Në procesin penal shkaqet e papranueshmërisë së ankimit parashikohen në nenin 420 të Kodit të Procedurës Penale.

15.6 Në interpretim të dispozitës së mësipërme ligjore rezulton se ligjvënësi ka caktuar si rastet kur mund të bëhet ankim, ashtu edhe subjektet që legjitimohen të bëjnë ankim ndaj vendimeve dhe urdhrave të gjykatës. Në rastin konkret, edhe në vlerësimin e këtij kolegji të Gjykatës së Posaçme të Apelit, ky disponim i drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme me shkresën Nr.K. 137/1.Prot.A/SH, date 24.02.2023, konform nenit 28 të Kodit të Procedurës Penale, për kalimin e akteve një prokurorie tjetër, është i paankimueshëm në gjykatë.

15.7 Në situatën kur procedohet në fazën e hetimit për kalimin e akteve një prokurorie tjetër, sipas nenit 28 të Kodit të Procedurës Penale, ashtu dhe në rastin kur kërkohen aktet nga një prokurori tjetër, sipas nenit 29 të Kodit të Procedurës Penale, nenet në fjalë, përfshirë dhe nenet 84, pika 1 dhe 89, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale, nuk parashikojnë taksativisht të drejtën e kundërshtimit në gjykatë të disponimit të prokurorit "Për kalimin e akteve një prokurorie tjetër", pra konstatimin e moskompetencës së vet (terminologji e nenit 84, pika 1).

15.8 Ky kolegji arsyeton se, duke iu përcjellë aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nuk përjashtohet mundësia e zbatimit të nenit 28, pika 3 apo 29, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale, apo situata kur aktet mund t'i dërgohen nga kjo prokurori që heton (ajo pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) për kompetencë një prokurorie tjetër të juridiksionit të zakonshëm (nenet 28, pika 2 dhe 29, pika 2). Vetë neni 84, pika 1, "Moskompetenca e shpallur gjatë hetimeve paraprake", parashikon se kur gjatë hetimeve paraprake ose në përfundim të tyre prokurori konstaton moskompetencën e vet për çdo lloj shkak vëndos dërgimin e akteve prokurorit pranë gjykatës kompetente.

15.9 Në rast mosdakordësimi në veprimtarinë e prokurorëve, pra në fazën e hetimit lidhur me kompetencën, kjo zgjidhet me ndërhyrjen e Prokurorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe kjo rezulton nga neni 89, pika 2: ... Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, në rast konflikti gjatë hetimeve paraprake ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe një prokurorie tjetër, ka përparësi kompetenca dhe juridiksioni i së parës dhe se zbatohen parashikimet e nenit 28 të Kodit të Procedurës Penale "Kalimi i akteve një prokurorie tjetër" si dhe të nenit 29 të Kodit të Procedurës Penale "Kërkimi i akteve një prokurorie".

15.10 Në rrethanat që shkresa nr. K.137/1. Prot. A.SH., datë 24.02.2023 është shkresë përcjellëse e kallëzimit, dhe si e tillë nga ana e legjislatorit nuk është parashikuar ankim në gjykatë, nëse Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm pranë së cilës janë dërguar materialet kallëzuese, do të vlerësojë se nuk është kompetente për trajtimin e kallëzimit të përcjellë nga Prokuroria e Posaçme, nga ana e legjislatorit në nenet 28, 29, 83, 84 dhe 89 të Kodit të Procedurës Penale, është parashikuar edhe mënyra sesi zgjidhet kjo situatë juridike, trajtuar si më sipër.

15.11 Për rrjedhojë, në kushtet që ndaj disponimit të Prokurorit, sipas nenit 28 të Kodit të Procedurës Penale, për kalimin e akteve një prokurorie tjetër, ligji nuk ka njohur shprehimisht të drejtën e kundërshtimit të tij në gjykatë, Gjykata e Posaçme e Apelit, çmon se edhe vendimi nr.107, datë 29.03.2023, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, me të cilin është disponuar mbi një kërkesë që nuk parashikohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, është i paankimueshëm.

15.12 Ankuesja Rajmonda Nika, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, ngre pretendime që, subjektet e kallëzuara, janë subjekte të posaçëm, si dhe veprat penale që ata kanë kryer janë në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme. Sipas ankuesit, Prokuroria e Posaçme, ka detyrimin ligjor, që në çdo rast të shprehet me një vendim mosfillimi ose pushimi, duke i dhënë mundësi ankuesit ta ankimojë këtë vendim, duke e kaluar atë në filtrat e gjykatave të posaçme si dhe, ngre pretendime për faktin që ka prova të rëndësishme që tregojnë përfshirjen e subjekteve të kallëzuara në këtë veprimtari kriminale, të kryer në formën e organizatës kriminale. Gjykata e Posaçme e Apelit, rreth këtyre pretendimeve, arsyeton se faktet historike



të kallëzuara në kallëzimin penal nr.137 prot., datë 16.02.2023, paraqiten të njëjta me ato të kallëzimit penal nr.285/2011, që bën fjalë për ngjarjen e datës 21.01.2011, ku mbetën të vrarë të ndjerët Aleks Nika, Hekuran Deda etj, si dhe mbetën të plagosur disa persona të tjerë, për të cilin tashmë, Prokuroria e Posaçme ka disponuar për kalimin e akteve për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Ndryshimi ndërmjet kallëzimeve konsiston në atë se, në kallëzimin nr.137, datë 16.02.2023, faktet historike të parashtruara si vepra penale pretendohen nga kallëzuesi si të kryera nga subjekte të posaçëm, në kuadër të një organizate kriminale, hetimi i të cilave është në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme sipas përcaktimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

15.13 Ky Kolegj i Gjykatës së Posaçme të Apelit, thekson se, akti objekt kundërshtimi, duke mos qenë një vendim mosfillimi apo për pushimin e procedimit penal, nuk ka asnjë fuqi detyruese për prokurorin kompetent që do të vijojë hetimet në lidhje me kallëzimin penal nr.137 prot, datë 16.02.2023. Pavarësisht qëndrimit të mbajtur nga ana e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në shkresën Nr.K.137/1.Prot. A.SH., datë 24.02.2023, mbi mungesën e indicjeve për elementë të figurave të veprës penale të parashikuara nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, apo se nga hetimet e kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nuk ka rezultuar që autorë të mundshëm të veprës penale, të jenë subjekte për hetimin e të cilëve kompetente është Prokuroria e Posaçme, Prokurori kompetent që do të vijojë hetimet lidhur me këtë material kallëzues, duhet të ushtrojë ndjekjen penale në pavarësi të plotë, duke kryer çdo veprim hetimor që ai e çmon të nevojshëm, pa asnjë pengesë ligjore për të hetuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme mbi çdo fakt të kallëzuar dhe për çdo subjekt të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale. Pikërisht, duke pasur parasysh këtë parashikim ligjor, në shkresën tij nr.K.137/1.Prot A.SH., datë 24.02.2023, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, citohet se "[...] nëse në vijim të verifikimeve apo hetimeve do të konstatohet ekzistenca e ndonjë vepre penale apo subjekt në kompetencë hetimi sipas nenit 75/a të KPP atëherë aktet e procedimit penal të dërgohen për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Posaçme, referuar edhe nenit 28 të K.Pr.Penale."

15.14 Veç sa më lart, Gjykata e Posaçme e Apelit, sqaron se, gjatë seancës paraprake, ankuesja, ka mundësi të parashtrijë të gjitha pretendimet e saj, si mbi rrethin e subjekteve të përfshira në këtë veprimtari kriminale, ashtu edhe mbi cilësimin juridik të fakteve sipas vlerësimit të saj, dhe nëse kjo vlerësohet e drejtë, gjyqtari i seancës paraprake, referuar nenit 332/d, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me nenin 332/dh, pika 1, gërma "d", të Kodit të Procedurës Penale, ka të drejtë të deklarojë moskompetencën dhe të dërgojë çështjen në gjykatën kompetente. Gjithashtu, pretendimet e ankueses mbi nevojën për t'u kryer një sërë veprimesh të tjera hetimore që ajo i vlerëson se duhet të kryhen, tashmë mund t'i adresohen prokurorisë kompetente.

15.15 Si përfundim, duke mos iu njohur e drejta të pandehurit, viktimës dhe palëve private, e një kërkesë/kundërshtimi në gjykatë tek gjyqtari i hetimit, ndaj vendimit të prokurorit për kalimin e akteve për kompetencë një prokurorie tjetër (arsyetuar drejtë edhe nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë), është logjike që nuk njihet as e drejta e ankimit në Gjykatën e Apelit ndaj vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë që nuk ka pranuar një ankim të tillë, pikërisht për këtë shkak (duke arsyetuar edhe faktin se tashmë hetimet vijnë pranë një Prokurorie tjetër).

15.16 Për sa u arsyetua më lart, Gjykata e Posaçme e Apelit, konkludon se vendimi nr.107, datë 29.03.2023, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është i paankimueshëm dhe se, në bazë dhe për zbatim të shkronjës "b", të nenit 420, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale, ky ankim nuk duhet të pranohet.

**16. Kundër vendimit nr. 92 (87-2023-136), datë 21.06.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit, ka paraqitur rekurs, më datë 17.07.2023 (dorëzuar në postë në datë 14.07.2023), kallëzuesja/kërkuesja Rajmonda Nika, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, Av. Idajet Beqiri, me**

të cilin ka kërkuar: “Prishjen e Vendimit të Gjykatës së Posaçme Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Nr.107, datë 29.03.2023 si dhe të Vendimit Nr.92, datë 21.06.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit Për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar dhe urdhërimin e Prokurorisë së Posaçme Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për të regjistruar procedimin penal dhe për të hetuar çështjen penale të kallëzuar nga viktimat e krimit të kallëzuarve Sali Berisha, ish- Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, Lulzim Basha, ish - Ministër i Brendshëm dhe Ndrea Prendi ish - Komandanti i Gardës së Republikës etj, si organi i vetëm që ka kompetencën lëndore.” Në rekurs kërkesja, ndër të tjera, ka parashtuar këto shkaqe:

- Thelbi i ankimit tonë është mospajtimi me qëndrimin e SPAK, i cili vlerëson se kallëzimi penal i paraqitur prej nesh kundër zyrtarëve të lartë të shtetit, subjekte të kompetencës së SPAK, sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, nuk është në kompetencën e tyre, por në kompetencë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Këtë "mungesë kompetence" Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e "arsyeton" me faktin se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në datën 02.04.2021, ka rifilluar procedimin penal për vrasjet shtetërore të 21 janarit 2011.

- Në radhë të parë, kjo "lënje e topit në derë" të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nga ana e SPAK, nuk gjen mbështetje ligjore, pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk ka në hetim gjithë procesin e 21 janarit me të gjitha vrasjet dhe plagosjet që u bënë këtë ditë, por në datën 02.04.2021 kanë rifilluar procedimin penal për moszbardhjen e vrasjes vetëm të Aleks Nikës, sepse nuk është ekspertuar arma që nxorri plumbin vdekjeprurës të tyre, ndërsa pjesët e tjera të këtij procesi kjo prokurori i konsideron të mbyllura në bazë të vendimit gjyqësor të formës së prerë të dënimit të gardistëve.

- Ndërsa kallëzimi penal i është drejtuar Prokurorisë së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar jo për ekzekutorët e këtij krimi shtetëror, por për organizatorët dhe urdhëruesit e këtyre vrasjeve të cilët kanë një emër dhe një mbiemër, e që quhen Sali Berisha, ish Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Lulzim Basha, ish Ministër i Brendshëm etj., të cilët në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale janë subjekte që hetohen dhe gjykohen nga Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- Në një situatë të tillë, nëse vërtetë ka rifilluar në datën 02.04.2021 procedimi penal për zbardhjen e vrasjes të Aleks Nikës (por që për plot 2 vjet e 6 muaj nuk është bërë asnjë veprim), pasi Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka marrë kallëzimin penal nga viktimat e krimit, si organi i vetëm kompetent për të hetuar, filluar, pushuar apo dërguar në gjyq procedimin penal kundër ish Kryeministrit të Shqipërisë Sali Berisha dhe ish Ministrin të Brendshëm Lulzim Basha, duhet të tërhiqte dosjen përkatëse të këtij procedimi penal që bën fjalë për ekzekutorët gardistë të këtyre vrasjeve shtetërore nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe të fillonte procedimin penal, si organ akuze kompetent në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

- Nisur sa sipër Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duhet t'i japi përgjigje vetëm këtij fakti, është apo nuk është SPAK organi kompetent që duhet të regjistroj fillimin e procedimit penal kundër ish Kryeministrit dhe ministrit të Brendshëm si urdhëruesit, organizatorët dhe frymëzuesit e vrasjeve shtetërore dhe të masakrës së 21 janarit 2011. Pra nuk kemi të bëjmë me një vendim të paankimueshëm, por kemi të bëjmë me një ankim që kundërshton vendimin e Prokurorit të SPAK i cili me shkresën Nr.K. 137/1 Prot. A.Sh, datë 24.02.2023 thekson qartazi se ia ka dërguar kallëzimin penal të viktimave kundër funksionarëve më të lartë të shtetit, organizatorë dhe urdhërues të vrasjeve shtetërore për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në një kohë që kjo Prokurori nuk është kompetente në zbatim të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

- Qëndrimi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ndaj kallëzimit penal të viktimave të 21 janarit është i qartë, varrosja e së vërtetës, varrosja e drejtësisë, siç u varrosën 4 dëshmorët e atdheut, pa patur të drejtë familjarët e viktimës as të bëjnë ankim kundër këtij veprimi antiligjor mosdëshkues ndaj funksionarëve më të lartë të shtetit që i bënë këto 4 vrasje.

- Kallëzuesja, ka cilësinë e viktimës së krimit dhe të drejtat e viktimës së krimit janë parashikuar me hollësi në nenin 58 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Kësaj viktime, në datën 21 janar 2011, për motive të dobëta të karakterit politik, nga një organizate kriminale, e veshur me pushtet të lartë shtetëror, që kryesohej nga ish Kryeministri Sali Berisha, ish Ministri i Brendshëm Lulzim Basha dhe ish Komandanti i Gardës së Republikës Ndrea Prendi, i është vrarë me armë zjarri bashkëshorti Aleks Nika.

- Kallëzuesja ka paraqitur në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar një kallëzim penal, kallëzim i cili është regjistruar në sekretarinë e këtij organi akuze me Nr. K.137 Prot, datë 16.02.2023.

- Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me një shkresë të tij - Nr.K. 137/1 Prot. A.Sh, datë 24.02.2023 - sikurse e konsideron ky organ si dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë këtë akt, me anën e të cilës ka shpallur mungesën e kompetencës lëndore dhe ka vendosur dërgimin e çështjes kundër të kallëzuarve Sali Berisha, ish Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, Lulzim Basha, ish Ministër i Brendshëm dhe Ndrea Prendi ish Komandanti i Gardës së Republikës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

- Përmes kësaj shkrese (të cilin Gjykata e Posaçme në vendimin e saj objekt apelimi herë e konsideron shkresë, herë e konsideron vendim për moskompetencë lëndore), Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar arsyeton se nga verifikimi që ka bërë në sektorin e Protokoll/Arkivës evidentohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 285, datë 21.01.2011, që bën fjalë për veprën penale "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese", parashikuar nga neni 79, germa "dh" dhe "ë" të Kodit Penal, për të cilën, në datën 02.04.2021 kanë rifilluar hetimet e pezulluara, me qëllim identifikimin e autorëve të vrasjes së shtetasve Aleks Nika dhe Hekuran Deda, si dhe plagosjen e disa shtetasve të tjerë.

- Më tej Drejtuesi i SPAK në shkresën e tij arsyeton se nga përmbajtja e materialit kallëzues dhe verifikimi i kryer (pavarësisht se kallëzimi penal është depozituar në Prokurorinë e Posaçme duke u kallëzuar subjekte të posaçme për kryerje veprash penale në kuadër të një organizate kriminale) evidentohet e dhëna se, në lidhje me objektin e kallëzimit dhe faktet e pretenduara, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë po kryen hetime në kuadër të procedimit penal nr. 285/2011, për vepra penale që nuk janë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme.

- Gjithashtu, thekson më tej drejtuesi i SPAK në vendimin e tij, deri në këto momente të hetimit që po kryhet nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nuk rezulton të jenë identifikuar autorë të veprës penale dhe si rrjedhim, nuk është arritur të provohet se autorë mund të jenë subjekte të posaçme, sipas përcaktimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 3, të Ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

- Nëse në vijim të verifikimeve dhe të hetimeve, thekson në fund të shkresës së tij drejtuesi i SPAK, do të konstatohet ekzistenca e ndonjë vepre penale apo subjekt në kompetencë hetimi sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, atëherë aktet e procedimit penal të dërgohen për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, referuar dhe nenit 28 të Kodit të Procedurës Penale.

- Këtë akt të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar e ankimmuam në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila me Vendimin Nr. 107, datë 29.03.2023, vendosi mospranimin e ankimit dhe mosparashikimin e ankimit kundër tij.

- Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, për të shmangur veten nga një vendimmarrje ligjore, ka bërë në vendimin e saj shumë sofizma juridike, kontradiktore me njëra-tjetrën, duke u përqëndruar më shumë në gjëra që nuk kanë asnjë rëndësi për çështjen, por duke mos i dhënë përgjigjen ligjore kërkesës së viktimës së krimit, e cila, në bazë të nenit 58, pika "1", gërma "a", ka të drejtë të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit, gjë të cilën e ka bërë. Po kështu viktima e krimit ka të drejtë në bazë të nenit 58, pika "1", gërma "ë", e Kodit të Procedurës Penale të njoftohet për mosfillimin e procedimit penal, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit, sikurse në bazë të gërmës "f", të këtij neni, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mosfilluar procedimin penal.

- Përgjigja që viktima e krimit Rajmonda Nika, kërkonte prej Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë ishte që çfarë përfaqëson kjo e ashtuquajtur shkresë K.137/1 Prot. A.Sh, datë 24.02.2023, a i jep ajo përgjigje kallëzimit që ka bërë viktima për ndjekjen penale të fajtorëve që i kanë vrarë bashkëshortin e saj? Përmes kësaj përgjigje, a ka të drejtë ajo të ndjekë fatin e kallëzimit të saj, çfarë u bë me këtë kallëzim, u fillua apo nuk u fillua procedimi penal, nga e cila asaj i lind e drejta e ankimit?! Cili është mjeti ligjor që kjo viktimë do të realizojë të drejtat e saj që i jepen nga neni 58 i Kodit të Procedurës Penale, kur Gjykata këtë akt të prokurorit, që në thelb është ngritja e problemit të kompetencës lëndore, e konsideron shkresë të paankueshme, në një kohë që kjo "shkresë" mbyll përfundimisht kallëzimin dhe efektet e tij?!

- Viktima e krimit ka bërë një kallëzim dhe kërkon ndjekjen penale të fajtorëve Sali Berisha, Lulzim Basha dhe Andrea Prendi, si autorë të veprës penale të vrasjes politike të bashkëshortit të saj. Ndryshe nga sa bëjnë sofizma Prokurori dhe Gjykata e Shkallës së Parë, ajo autorët e krimit i stigmatizon me funksione, me emra dhe me veprime konkrete që ata kanë bërë për vrasjen e bashkëshortit të saj. Këta persona janë me funksione të tilla, që kompetente për ndjekjen e tyre penale është Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në vështrim të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale si dhe të nenit 3, të Ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

- Në një situatë të tillë organi i akuzës dhe Gjykata e Shkallës së Parë nuk duhet të bëjnë rolin e "strucit" me futjen e kokës në rërë për të mos e parë, duke thënë"... nuk rezulton të jenë identifikuar autorë të veprës penale dhe si rrjedhim, nuk është arritur të provohet se autorë mund të jenë subjekte të posaçme, sipas përcaktimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 3 të Ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Autorët, funksionet e tyre, rolin e secilit prej tyre, po jua identifikon viktima i krimit me emër dhe mbiemër, me funksionet që kanë patur dhe me rolin e secilit prej tyre.

- Në këto kushte drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka në kompetencë vetëm ato që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale dhe jo të nxjerrë "shkresa" të cilat sfumojnë dhe hedhin në koshin e plehrave ato që ka vendosur ligjvuesi për të bërë organi i akuzës në raste të një kallëzimi penal që bën viktima e krimit për ndjekjen penale të fajtorëve që i kanë shkaktuar tragjedinë familjare. Prokurori ka detyrë ligjore të mosfillojë procedimin penal, dhe me vendim të arsyetuar ja komunikon palëve të interesuara, të cilat kanë të drejtën e ankimit, ka të drejtë ligjore të filloi procedimin penal, të dërgojë çështjen në gjyq, të pushojë procedimin penal, të shpallë ose të ngrejë konfliktin e kompetencës lëndore apo tokësore etj. Për të gjitha vendimmarrjet e tij për sa më sipër, viktima që ka bërë kallëzimin ka të drejtën e njoftimit dhe të ankimit për të realizuar të drejtat e tij.



- Në rastin konkret, nëse shkresa Nr.K. 137/1 Prot. A.Sh, datë 24.02.2023, është "vendim" për mungesë kompetence lëndore, viktimja e krimit ka bërë një ankim në Gjykatën e Posaçme, si organi që është kompetent të vlerësojë këtë fakt, domethënë ekzistencën e kompetencës së SPAK, për këtë çështje dhe jo "pasimin" e qëllimshëm për "ta hequr qafe" kallëzimin nga mungesa e kurajos apo e arsyeve të tjera jo ligjore.

- Përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nr. 107, datë 29.03.2023, është kontraditor, i bie ndesh vetvetes në disa pika e paragrafe, herë i jep të drejtat që i përkasin viktimës së krimit, e më pas ja heq ato që arsyetohet vet më sipër, duke bërë një konglomerat të pakuptueshëm, të pazbatueshëm, të paorientueshëm dhe të paligjshëm, pasi nuk e orienton dhe as nuk e vë në binarët e ligjit organin e akuzës për të vepruar në rastin konkret dhe në raste të tjera analoge.

- Gjykata e Shkallës së Parë e kishte për detyrë ligjore të pranonte kërkesën e viktimës dhe t'i kthente Prokurorisë "shkresën" apo "aktin" e datës 29.03.2023, mbrapsht dhe ta orientonte duke i thënë: Përderisa keni marrë një kallëzim penal i cili ju specifikon emrat e autorëve të krimit, krimin që kanë kryer, funksionet që kanë pasur kur kanë kryer këtë krim autorët e dyshuar, ju si organi akuze keni për detyrë ligjore të dilni më një vendimmarrje që, ose vendosni mosregjistrimin e procedimit penal, dhe pala viktimë e krimit ka të drejtë të bëjë ankim, ose të mos e filloni procedimin penal, ose të filloni procedimin penal etj, dhe njoftoni për çdo vendimmarrje viktimën e krimit, e cila i gjenë vet mjetet e ankimit kundër vendimeve tuaja.

- Këtë gjë që duhet të bënte Gjykata e Shkallës së Parë, nuk e bënte, dhe kërkesës legjitime të viktimës së krimit, Rajmonda Nika, të bazuar në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale, e cila i kërkon kësaj Gjykate t'i jap përgjigjen çfarë u bë me kallëzimin penal që ajo ka paraqitur për vrasjen e bashkëshortit, çfarë vendimi është marrë, çfarë rruge ligjore ajo duhet të ndjeje që të kundërshtojë çdo llojë vendimmarrje të çdo organi që nuk respekton nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale.

- Në kallëzimin penal që i është drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kallëzim i cili është regjistruar në sekretarinë e këtij organi akuze me nr. K.137 Prot., datë 16.02.2023, theksohet se organizata kriminale që ekzekutoi Aleks Nikën, Ziver Veizin, Hekuran Dedën dhe Faik Myrtaj, si dhe që plagosi me armë zjarri një numër të konsiderueshëm personash të tjerë, kryesohej prej ish - Kryeministrit Sali Berisha, ish - Ministrit të Brendshëm Lulzim Basha, si organizator, frymëzues dhe urdhërues.

- Kjo organizatë kriminale kishte si ekzekutor, zbatues të urdhërave për vrasje, Ndre Prendi, Agim Llupo, Alfred Ahmetcenaj, Artan Hoxha (zëvendës komandant i Gardës së Republikës), Dashamir.. etj.

- Në kallëzimin penal evidentohen të gjitha provat direkte dhe indirekte që i identifikojnë qartë dhe pa më të voglin ekuivok të gjithë organizatën kriminale, me emra, me mbiemra, me funksione dhe me role të gjithsecilit. Pra nuk është e vërtetë sa pretendon drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në vendimin e tij Nr.K.137/1 Prot. A.Sh, datë 24.02.2023, se nuk rezultojnë të jenë identifikuar autorë të veprës penale dhe si rrjedhim, nuk është arritur të provohet se autorë mund të jenë subjekte të posaçme".

- Shkresa Nr.K.137/1 Prot. A.Sh, datë 24.02.2023, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar vjen në kundërshtim të hapur me provat, sikurse janë deklarimet e vet kokës së organizatës kriminale, ish Kryeministrit Sali Berisha, i cili me gojën e tij, me figurë, botërisht, ka pranuar gjithë skemën e organizimit të organizatës kriminale, të pozicionimit të secilëve prej anëtarëve të saj, të urdhërave që u dhanë.

- Shkresa Nr.K.137/1 Prot. A.Sh, datë 24.02.2023 i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar vjen në kundërshtim flagrant me provat direkte dhe indirekte, duke filluar me alibitë e ish Kryeministrit Sali Berisha për të fshehur veprimet e organizatës kriminale se vrasjet u bënë gjoja nga vet protestuesit, me zhdukjen e serverave të Kryeministrit me urdhër të ish këtij Kryeministri, me urdhërin që Sali Berisha i dha Policisë

së Shtetit për të mos ekzekutuar vendimet e arrestimit të gardistëve që ekzekutuan me armë zjarri 4 të vrarët dhe të dhjetra të plagosurit në 21 janar, me alibinë e tij se këto vrasje u bënë për shkak të një grushti shteti që organizoi kundër tij, si Kryeministër, ish Presidenti i Republikës, ish Prokurorja e Përgjithshme dhe kreu i opozitës shqiptare etj.

- Provë e rëndësishme që vërteton se urdhëruesi i këtyre vrasjeve ishte pikërisht ish Kryeministri Sali Berisha, është fakti se Komandanti i Gardës, pjestar i organizatës kriminale, pasi u thirr në zyrën e ish Kryeministrit për të marrë urdhërin e ekzekutimit të disa prej protestuesëve dhe bëri me të një debat të ashpër, i cili degjeneroi në ushtrimin e një dhune të rëndë fizike që ish Kryeministri ushtroi mbi Komandantin e Gardës Ndrea Prendi, ky i fundit veproi menjëherë me zinxhirin e anëtarëve të tjerë të organizatës kriminale dhe me armët e zjarrit të Gardës së Republikës, bëri masakrën shtetërore, duke vrarë 4 qytetarë të këtij vendi dhe duke plagosur dhjetëra të tjerë.

- Videopërgjimi i kësaj dite, i cili për fatin e keq, nuk u mor dhe nuk u administrua prej Drejtuesit të SPAK para se të dërgonte shkresën e tij Nr.K. 137/1 Prot. A.Sh, datë 24.02.2023, për të shpallur moskompetencën lëndore, është një provë shumë e rëndësishme e cila e bën kompetente vetëm SPAK për regjistrimin e këtij procedimi penal dhe hetimin e kësaj çështje.

- Në këtë provë të rëndësishme, të cilën Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar duhet t'a marrë, t'a administrojë dhe t'a analizojë veçmas dhe në tërësi me provat e tjera, del qartë dhe pa ekuivoqe se ka dyshime të arsyeshme, madje tej çdo dyshimi, se kemi të bëjmë me një organizatë të mirëfilltë kriminale të krijuar për të bërë vrasje politike, e cila parashikohet si vepër penale e rëndë në nenin 333 i Kodit Penal, sikurse këto 4 vrasje dhe numri i personave të plagosur janë kryer nga kjo organizatë kriminale, vepër penale kjo e parashikuar nga neni 334 i Kodit Penal.

- Nga ana tjetër, me ndryshimet kushtetuese, të miratuara nëpërmjet ligjit nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", (të ndryshuar), ndër të tjera, në nenin 135 të saj është parashikuar ngritja e Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila gjykon veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, apo edhe akuzat ndaj ish- funksionarëve të mësipërm...

- Nisur sa sipër, kur kallëzimi penal është bërë kundër ish - Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe deputetit të sotëm Sali Berisha, kundër ish - ministrit të Brendshëm dhe deputetit të sotëm Lulzim Basha etj., kur në kallëzimin penal evidentohen prova, fakte dhe dyshime të arsyeshme se jemi para një organizate kriminale, e cila ka kryer krime të rënda, disa vrasje të cilësuar dhe plagosje të shumta, siç parashikohet në nenet 333 dhe 334 të Kodit Penal, kompetencën lëndore për hetimin e kësaj çështje nuk e ka Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, por Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

- Ndaj kjo Prokurori e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar duhet të regjistrojë procedimin penal si organi që ka kompetencën lëndore në vështrim të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 3 të Ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, dhe të nisë hetimet, duke i kërkuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për të bërë pjesë përbërëse të këtij procedimi penal dosjen përkatëse që ajo Prokurori disponon lidhur me këtë krim të rëndë shtetëror të 21 janarit 2011.

- **Përfaqësuesi ligjor i kërkuesses Rajmonda Nika, më datë 22.12.2023, ka paraqitur kërkesë me shkrim për çështjen (si dhe Vendim të GJEDNJ Nika kundër Shqipërisë, datë 14.11.2023, versioni shqip), duke parashtruar se:**

- Ashtu siç tashmë jeni në dijeni Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përfunduar gjykimin e çështjes që i përket aplikimit/kërkesës nr. 1049/17 Nika kundër Shqipërisë duke marrë edhe vendimin nr. ECHR - LE20 2R 210, datë 14 nëntor 2023. Nga gjykimi i zhvilluar, Gjykata përfundimisht ka konstatuar kërkesën e kërkuesses si të pranueshme dhe njëkohësisht ka konstatuar shkelje të aspektit procedural dhe të aspektit material të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

- Po ashtu, në paragrafin 178 të Vendimit të saj, Gjykata është shprehur: “Për sa u përket masave individuale, Gjykata vëren se hetimi penal është ende i hapur. Duke pasur parasysh këtë, ajo konsideron se autoritetet duhet të vazhdojnë (për aq sa kjo është e mundur) përpjekjet e tyre që synojnë zbardhjen e rrethanave të vdekjes së A. N. dhe identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës, aty ku është e përshtatshme”.

- Në kuadër të detyrimit që buron nga neni 46 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Republika e Shqipërisë si Palë e Lartë Kontraktuese, ka detyrimin të zbatojë vendimin nr. ECHR - LE20.2R 210, datë 14 nëntor 2023, të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut sa i përket marrjes së masave individuale të referuara më sipër.

- Në konsideratë të kësaj vendimmarrjeje, kërkojmë nga ana juaj që të merrni parasysh përfundimet e kësaj Gjykate, me qëllim që t'i hapet rrugë ligjore rivendosjes së të drejtës së familjarëve të të ndjerit Aleks Nika në kushtet kur rrethanat e vdekjes së tij ende vijojnë të mos jenë të zbardhura që prej datës 21.01.2011, ku ai humbi jetën gjatë një proteste në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit”.

## II. Vlerësimi i Kolegjit Penal

17. Fillimisht, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se rekursi është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim KPP). Rekursi i është komunikuar Prokurorisë së Posaçme.

18. Shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë parashikohen nga neni 432, i KPP. Kjo dispozitë, në momentin e paraqitjes së rekursit, në pikën 1, parashikonte se: “1. Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe: a) për mosrespektimin ose për zbatimin e gabuar të ligjit penal; b) për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të këtij Kodi; c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.”. Duhet sjellë në vëmendje se Gjykata e Lartë është një gjykatë ligji, të cilës palët mund t'i drejtohen vetëm për shkaqet e përcaktuara në nenin 432 të KPP. Pretendimet në lidhje me vlerësimin e gabuar të fakteve dhe provave, nuk merren në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, pasi kjo është një çështje që del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj. Pavarësisht se Gjykata e Lartë nuk i hyn vlerësimit të provave në çështjen objekt gjykimi, është në kompetencën e saj që të shqyrtojë nëse nga gjykatat më të ulëta është zbatuar drejt ligji dhe nëse vendimmarrja e tyre është në standardet e një vendimmarrje të arsyetuar, duke marrë për bazë edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

19. Referuar disponimeve të gjykatave të shkallëve më të ulëta – disponimit të gjyqtarit për hetimet paraprake (pranë Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar) dhe të Gjykatës të Posaçme të Apelit (miratues të këtij të fundit) – të cilat - kanë refuzuar gjykimin e ankimeve të paraqitura, pranë këtyre gjykatave – prej kërkuesses Raimonda Nika - në cilësinë e kallëzueses – dhe të ankimueses - ndaj disponimit të prokurorit (drejtuesit)

të Prokurorisë Speciale – që - me shkresën nr. K.137/1 Prot.A/SH, të datës 24.02.2023 – lidhur me kërkesën për regjistrimin e çështjes penale mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga kjo e fundit dhe trashëgimtarët dhe të afërmit e viktimave të ngjarjes se 21 janarit – ndaj zinxhirit drejtues qeverisës “menaxhues” – në mënyrë të drejtpërdrejtë – të situatës të krijuar mbas protestës se organizuar prej opozitës, me datë 21 janar 2011 – ndaj ndërhyrjes së Njësiwe Speciale të Gardës – degradimit të saj në masakër – me urdhërimin e vrasjes së katër protestuesve dhe plagosjes së shumë të tjerëve (të ekzekutuara prej njësiwe të Gardës) – ka “dërguar” kallëzimin në fjalë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e motivuar këtë qëndrim me “mungesën e indicieve” për elemente të figurave të veprës penale, të parashikuara nga neni 75/a i KPP, pra – në mungesën e rekuizitave të regjistrueshmërisë (pranë kësaj Prokurorie) të njoftimit të marrë nëpërmjet kallëzimit - e “konfirmuar kjo përshtypje” - nga hetimet e kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë (ku prej vitesh është regjistruar procedimi penal nr.285, datë 21.01.2011, për veprën penale të “vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79/dh/e/ të Kodit Penal, i rihapur me datë 02.04.2021, lidhur me zbulimin e autorëve të vrasjes së Aleks Nikes, Hekuran Dedes dhe të plagosjeve të personave të tjerë) – rezultatet e të cilave (për momentin) nuk kanë prodhuar asnjë rezultat lidhur me identifikimin e autorëve të mundshëm – subjekte të posaçme – bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale të sipërcituar – që “do të justifikonin aktivimin e kompetencës së Prokurorisë Speciale – të drejtuesit të saj - për të tërhequr dhe regjistruar procedimin penal në ngarkim të këtyre subjekteve” – ballafaqimit të përmbajtjes së tyre - me shkaqet mbështetëse të rekursit - Kolegji - konsideron të verifikuar - në cilësinë e “shkakut” - integrues të pranueshmërisë së rekursit (dhe të aktivimit automatik të funksionit kontrollues të karakterit ligjor dhe nomofilatik të juridiksionit të Gjykatës së Lartë) – zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal (me rëndësi për zhvillimin e praktikës gjyqësore), të përcaktuar në germen “a”, të kësaj dispozite – nenit 432/1 të KPP – prej këtyre gjykatave – në kushtet e ometimit të tyre për të trajtuar (për t’u shprehur - mbi bazën e ankimit të viktimës ndaj këtij disponimi të prokurorit) ) ligjshmërinë e disponimit të prokurorit (drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme) lidhur me kallëzimin e paraqitur prej viktimës (të afërmeve të saj) së veprës penale – disponim i cili – sikurse evidentohet në përmbajtjen e tij (të referuar sa më sipër) – pavarësisht veshjes formale – qartazi është prononcuar “mbi mungesën e indicieve” për elemente të figurave të veprës penale të kryera nga subjekte të parashikuara nga neni 75/a i KPP ( pra në thelb – mbi mungesën e rekuizitave – cilësive - të regjistrueshmërisë së njoftimit për veprën penale - notitia criminis - të ardhur nëpërmjet kallëzimit të viktimës Nika) – i konfirmuar ky konkluzion – sikurse citohet në disponimin e prokurorit (drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme) edhe prej “rezultateve të hetimeve paraprake të zhvilluara nga prokurori pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë - ku - prej vitesh hetohet lidhur me këtë ngjarje ( hetime të orientuara kryesisht në drejtim të verifikimit të përgjegjësisë, në nivelin ekzekutiv, të realizimit të saj) – të cilat nuk kanë prodhuar asnjë rezultat edhe përsa i përket identifikimit të autoreve të mundshëm – subjekte të posaçme – të nivelit të lartë drejtues – bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale të sipërcituar”.

20. Në funksion të argumentimit të këtij konkluzioni - Kolegji do të evidentoje paraprakisht – nëpërmjet një excursus-i të shkurtër - itinerarin (iter-in) procedural të trajtimit (prej organit të procedimit penal – prokurorit - dhe me pas, mbi bazë ankimi ndaj disponimit të këtij të fundit – të disponimeve të gjykatave – të shkallës së parë – gjyqtarit për hetimet paraprake – dhe të shkallës së dytë – refuzuese të trajtimit të këtij ankimi) të kërkesës së paraqitur - në formën e kallëzimit – në Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë 16.02.2023, prej kallëzueses (ndër të tjerë) - shtetases Rajmonda Nika – në cilësinë e trashëgimtarëve (të afërm) të viktimave të kësaj ngjarje – për regjistrimin e procedimit penal, në konformitet me përcaktimet e paragrafit të parë, të nenit 287 të KPP - në thelb – të njoftimit për veprën penale (notitia criminis) të “vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”,



kundër dy a më shumë personave, në bashkëpunim (në formën e organizates kriminale), të parashikuar nga nenet 79/dh/e/ - 28 të Kodit Penal - të kryer nga subjekte të posaçëm (sipas percaktimit të nenit 75/a të KPP – germat “c” dhe “c” të kesaj dispozite – të cilat percaktojnë se: germa “c “ – akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave etj. janë në kompetencë gjykimi të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar sikurse – sipas germës “c”, të të njejtës dispozite – akuzat penale kunder ish funksionareve të mësipërm) - të identifikuar në shtetasit - Sali Berisha (ish-kryeministër i Republikës së Shqipërisë, në rolin e organizatorit), Lulzim Basha (ish-ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme, në rolin e organizatorit), Andrea Prendi (ish-komandant i Gardës së Republikës, në rolin e organizatorit, nxitësit dhe ekzekutorit), por edhe ndaj bashkepunoreve (ekzekutorë materiale) që nuk e kanë “statusin” e këtij lloj subjekti si p.sh. – shtetasi Agim Llupo. Shtetasit e sipërcituar janë kallëzuar për kryerjen e veprës penale të sipërcituar në kushtet kur (gjithnjë sipas përmbajtjes së kallëzimit) më datë 21.01.2011 - kanë shkaktuar vdekjen e qytetareve Aleks Nika, Zyver Veizi, Hekuran Deda dhe Faik Myrtaj, si dhe plagosjen e shumë personave të tjerë, të cilët në kohën që është kryer vepra ndodheshin jashtë territorit të rrethuar të godinës ku ndodhet selia e kryeministrit. Sipas palës kallëzuese, kjo vepër është kryer në një kohë kur tubimi i organizuar nga opozita e kohës kishte përfunduar. Në përmbajtje të kallëzimit tregohen faktet, si dhe provat në mbështetje të faktit të kallëzuar, si dhe provat që kërkohen të merren nga organi procedues (prokuroria).

21. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, nëpërmjet shkresës me Nr.K. 137/1.Prot. A/SH, datë 24.02.2023, ka disponuar – mbasi ka konstatuar (sikurse u sipërcitua) mungesën e kushteve të rregjistrueshmerise se kallëzimit të paraqitur prej viktimes Nika – në thelb - të inekzistences së njoftimit për veprën penale (kryerjen e saj prej subjekteve të posaçëm) – dërgimin e kallëzimit penal për kompetencë lëndore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Në përmbajtje të kësaj “shkresë” (në justifikim të qëndrimit të tij) prokurori ka evidentuar se - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (lidhur me kallëzimin e e paraqitur nga kallzuesja Nika) ka të regjistruar procedimin penal nr. 285, datë 21.01.2011, për veprën penale “Vrasja në rrethana cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, shkronjat “dh” dhe “ë” të Kodit Penal, hetimet për të cilin kanë rifilluar më datë 02.04.2021, me qëllim identifikimin e autorëve të vrasjes së shtetasve Aleks Nika, Hekuran Deda si dhe plagosjen e disa shtetasve të tjerë dhe se nuk ka të regjistruar (deri në momentin e dërgimit të kesaj shkresë) në rregjistrin e njoftimit të veprave penale (pranë asaj prokurorie) emra të personave që i atribuohet kjo vepër penale. Me argumentin se në lidhje me objektin e kallëzimit penal dhe faktet e pretenduara Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë po kryen hetime në kuadër të procedimit penal Nr.285/2011, për vepra penale që nuk janë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme dhe se - deri në këto momente - nuk rezultojnë të jenë identifikuar autorë të veprës penale dhe si rrjedhojë nuk është arritur të provohet se autorë mund të jenë subjekte të posaçme sipas percaktimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 3, të ligjit nr. 95/2016 - Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme - në konformitet edhe me percaktimet e neneve 75/a, 28, 76 të Kodit të Procedurës Penale – ka konkluduar se kallëzimi penal duhet të përcillet për kompetencë lëndore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me qëllim vlerësimin nga ana e kësaj prokurorie.

22. Duke mos qenë dakord me këtë disponim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, kallzuesja Rajmonda Nika, më datë 03.03.2023, ka paraqitur përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – gjyqtarit për hetimet paraprake pranë asaj Gjykate – fillimisht dhe – më pas – përpara Gjykatës së Apelit – ankim (oponence) ndaj këtij disponimi. Gjykatat e Posaçme kanë mbajtur të njëjtin qëndrim, duke vendosur mospranimin e ankimit. Në thelb të vendimmarrjes, gjykatat e posaçme, kanë argumentuar se: në rastin konkret, (sipas gjyqtarit për hetimet paraprake) nuk evidentohet “vullneti i prokurorit të Prokurorisë së Posaçme - për të mos ushtruar ndjekjen penale” përse kohë që “qartazi – në

përmbajtjen e shkresës së drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme – është bërë vlerësimi paraprak i të dhënave objekt kallëzimi” - dhe se “shkresa në fjalë nuk përmban asnjë të dhënë ose element që të vlerësohet në drejtim të kontrollit mbi vullnetin (apo mungesën e tij) e organit të procedimit penal – prokurorit – për ushtrimin e ndjekjes penale – çka delegjtitmon ankimin e paraqitur nga kallëzuesja Nika - para gjyqtarit për hetimet paraprake - në funksion të aktivimit të rolit të tij si garant dhe kontrollues i ligjshmërisë së vendimmarrjes së këtij të fundit (prokurorit) lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale mbi bazën e fakteve objekt kallëzimi”. Vendimmarrja e Prokurorisë të Posaçme (drejtuesit të saj) për dërgimin e materialeve kallëzuese për kompetencë (lëndore në këtë rast) tek një prokurori tjetër (Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë) nuk parashikohet nga ligjvënësi si vendimmarrje e ankimeshme në rrugë gjyqësore aq më tepër në kushtet kur prokurori nuk ka disponuar me një vendim mosfillimi përse kohë që kjo “shkresë”(nga forma përmbajtja apo efektet që sjell) nuk përbën një vendim mosfillimi por disponim të tij – sipas nenit 28 të KPP – për “kalimin e akteve” për kompetencë një prokurorie tjetër. Sakaq – sipas Gjykatës së Apelit – “shkresa” – e kontestuar – përbën një disponim të prokurorit - sipas përcaktimit të nenit 28 të KPP – për kalimin e akteve një prokurorie tjetër – i cili është i paankimeshëm – pavarësisht përmbajtjes së saj “ku kristalizohet qëndrimi i prokurorit – drejtuesit të prokurorisë speciale – evokues i mungesës së indicijeve për prezencë të elementeve të veprës penale në ngarkim të subjekteve të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a i KPP - i konfirmuar edhe prej hetimeve të zhvilluara nga prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë – të cilat nuk kanë evidentuar - përgjatë dinamikës shumëvjeçare të evoluimit të tyre - autore të mundshëm të veprës penale të identifikuar në subjekte të posaçëm”.

23. Kolegji konsideron vendimmarrjen e dy gjykatave – gjyqtarit për hetimet paraprake (pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar) dhe të Gjykatës së Apelit (që ka miratuar me të njëjtat argumente konkluzionin e asaj gjykate për verifikimin e kushteve të papranueshmerise se ankimit të paraqitur nga kallëzuesja Nika, ndaj disponimit të prokurorit për “kalimin e akteve – kallëzimit – për kompetencë – Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë - aktualisht - Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm”) të vesuar prej paligjshmërisë – zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal – në kushtet e ometimit të respektimit të përcaktimeve të nenit 291 të KPP – të cilat – imponojnë detyrimin e gjykatës – gjyqtarit për hetimet paraprake – për t’u prononcuar (mbi ankimin e kallëzuesit) - in primis - lidhur me disponimin e prokurorit për refuzimin e regjistrimit të procedimit penal mbi bazën e kallëzimit (të paraqitur në këtë rast nga shtetasi) – në thelb – të refuzimit (të këtij të fundit – prokurorit) për të konsideruar në cilësinë e “njoftimit për veprën penale”- notitia criminis – “lajmin” e marrë nëpërmjet kallëzimit të viktimës Nika – për kryerjen – nga subjekte të posaçëm – të identifikuara në ish – kryeministrin e qeverisë shqiptare për periudhën e viteve 2005 – 2013 – zotin Sali Berisha, ish - Ministrin e Brendshëm të qeverisë së dytë të tij për periudhën 2009 – 2013 dhe ish komandantin e Gardës së Republikës (të kësaj periudhë) – zotin Ndrea Prendi - të veprës penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 79/dh/ë/ të Kodit Penal – dhe –in secundis – të regjistrimit – për pasojë - të këtij “lajmi”- në regjistrin e njoftimit të veprave penale në konformitet me përcaktimet e paragrafit të parë, të nenit 287 të KPP.

24. Duke ju referuar konkluzioneve të gjyqtarit për hetimet paraprake pranë Gjykatës së Posaçme të shkallës së parë – argumentimit të këtyre konkluzioneve – Kolegji evidenton minimalisht një qëndrim kontradiktor (i cili mbështetet edhe prej konkluzioneve të Gjykatës së Apelit) në justifikimin e refuzimit të trajtimit/gjyqimit të ankimit të paraqitur nga kallëzuesi ndaj disponimit të prokurorit – përse kohë që - megjithëse konstaton qartazi “prononcimin e prokurorit lidhur me përmbajtjen e kallëzimit – i cili (gjithnjë sipas gjykatës) ka bërë vlerësimin paraprak të të dhënave objekt kallëzimi” (të konsideruara të papërshtatshme për të integruar rekuizitat e regjistrueshmërisë, pra, në thelb, të cilësisë së lajmit/njoftimit për veprën penale) -

konkludon, në të njëjtën kohë, se - përmbajtja e këtij prononcimi nuk evidenton vullnetin e prokurorit për të mos ushtruar ndjekjen penale pasi “shkresa (për kalimin e akteve për kompetencë një prokurorie tjetër – asaj pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas përcaktimit të nenit 28 të KPP) nuk përmban asnjë të dhënë ose element që të vlerësohet në drejtim të kontrollit mbi vullnetin (apo mungesën e tij) e organit të procedimit penal – prokurorit - për ushtrimin e ndjekjes penale”.

25. Në të njëjtat kushte të verifikimit të qëndrimit kontradiktor - Kolegji konsideron edhe vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit - refuzuese të gjyqimit të ankimit të kallzueses ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë - sipas të cilës – disponimi i prokurorit “për kalimin e akteve për kompetencë një prokurorie tjetër”, në konformitet me përcaktimet e nenit 28 të KPP, është i paankimueshëm megjithëse – “shkresa” – me të cilën është formalizuar ky qëndrim - në përmbajtjen e saj – “kristalizon qëndrimin e prokurorit – drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme – evokues i konstatimit (prej këtij të fundit) të mungesës së indicjeve për prezencë të elementeve të veprës penale në ngarkim të subjekteve të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a I KPP”.

26. Përtej “kapërcimit” logjik të sipërcituar – nihilizimit të evidencës së konstatuar ictu oculi prej vete gjykatave – të prononcimit - në thelb - të prokurorit – lidhur me pamundësinë e regjistrimit të çështjes penale mbi bazën e kallzimit të paraqitur nga kallzuesja – në kushtet e verifikimit të papërshtatshmërisë së njoftimit (përmbajtjes së tij) të marrë nëpërmjet këtij kallzimi për të disponuar rekuizitat (cilësitë) e notitia criminis – njoftimit për veprën penale (mungesa e indicjeve konfirmuese të elementeve të veprës penale në ngarkim të subjekteve të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a i KPP, e konfirmuar edhe prej hetimeve disavjeçare të realizuara, lidhur me të njëjtën ngjarje, prej Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) – këto të fundit (gjyqtari për hetimet paraprake dhe Gjykata e Apelit) – në justifikim të këtij qëndrimi – kanë legjitimuar (për më tepër) - në zbatim të gabuar të ligjit procedural – disponimin subsidiar të prokurorit (drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme) – të formalizuar me “shkresën” dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë - “për kalimin e akteve (kallzimit) për kompetencë kësaj prokurorie”, në konformitet me përcaktimet e nenit 28 të KPP – edhe në kushtet kur haptazi konstatohet që ky organ ka pengesë për të hetuar subjektet e posaçme të sipërcituara – pengesë e krijuar prej përcaktimit të nenit 75/a të KPP – që implikon detyrimin e Prokurorisë së Posaçme për të hetuar subjektet e posaçme (të përcaktuara në këtë dispozitë – nenin 75/a të KPP) dhe në eventualitet (në rastin e regjistrimit të procedimit penal prej kësaj Prokurorie) - për të tërhequr (në të kundërt me çka disponon përmbajtja e shkresës) - në konformitet me përcaktimet e paragrafit të tretë, të nenit 29 të KPP - duke shfrytëzuar rolin koordinues të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme - të atribuuar këtij të fundit prej kësaj dispozite - për zgjidhjen e konflikteve të këtij karakteri – aktet e procedimit të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm – në kushtet kur hetohet për të njëjtin fakt penal – “vrasjen në rrethana të tjera cilësuese”, në bashkëpunim (të shtetasve Aleks Nika etj) të parashikuar nga neni 79/dh/e/ të Kodit Penal, por ndaj ekzekutoreve materiale të realizimit të tij.

27. Kolegji konsideron – në kushtet e legjitimitetit aktivimin e prokurorit (përfshirë edhe atë të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në ushtrim të funksionit të përcaktuar në nenet 28/3 dhe 29/3 të KPP – rolit koordinues në zgjidhjen e konflikteve të kompetencës me prokuroritë pranë Gjykatave të Juridiksionit të Përgjithshëm kur procedohet njëkohësisht prej tyre ndaj të njëjtit person për të njëjtin fakt - ku, ky i fundit aktivohet gjithnjë, në thelb, në cilësinë e prokurorit), në konformitet me përcaktimet e nenit 28 të KPP – për deklarimin e “moskompetencës” së tij për të hetuar (për të vazhduar hetimet) - të evidentuar në kuadrin e hetimeve paraprake të zhvilluara prej tij mbas regjistrimit të procedimit penal mbi bazën e kallzimit apo të referimit të policisë gjyqësore – dhe të kalimit të akteve (të hetimit) një prokurorie tjetër – të çmuar si kompetente. Në terma të tjerë - sipas konsideratës së këtij Kolegji

– ky aktivim i prokurorit konsiderohet në kushte legjitimiteti – vetëm i konceptuar në kuadrin e procedimit penal të regjistruar mbi bazën e një lajmi/njoftimi për veprën penale të regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale në konformitet me përcaktimet e paragrafit të parë, të nenit 287 të KPP. Vetëm në këto kushte – të legjitimitetit të prokurorit për të disponuar titullaritetin e procedimit penal gjatë kësaj faze të procedimit - të hetimeve paraprake – në funksion të ushtrimit të ndjekjes penale – mund të justifikohet – mbi bazën e rezultateve – dinamikës – korrente të hetimeve – pozicionimi/qëndrimi i tij - reflektues i këtyre rezultateve – për të ndërprerë hetimet në kushtet e verifikimit të moskompetencës dhe për ti “transferuar” ato - nëpërmjet procedurës së kalimit të akteve (të parashikuar në nenet 28, 29, të KPP) - në prokurorinë (pranë Gjykatës) kompetente.

28. “Operimi” i prokurorit që deklaron moskompetencën vetëm në këtë kuadër legjitimiteti (të sipërcituar) imponon detyrimin e prokurorisë që i “drejtohet” kompetenca për ta pranuar apo për ta refuzuar (duke provokuar në eventualitet - konfliktin negativ apo pozitiv - sipas përcaktimeve të neneve 28 dhe 29 të KPP) – në një kohë që – jashtë këtij konteksti legjitimues – “disponimet” e prokurorit – humbasin karakterin juridiksional, me konsekuencë paragjykimin e fuqisë (efektit) detyruese të tyre.

29. Sipas konsideratës së këtij Kolegji - disponimi i prokurorit (drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme) i formalizuar me shkresën K.137/1, prot.A/Sh. date 24.03.2023, lidhur me kërkesën e trashëgimtarëve dhe të afërmeve të viktimave të ngjarjes së 21 janarit për regjistrimin e procedimit penal (mbi bazën e kallëzimit të paraqitur) për veprën penale të “vrasjes në rrethana të tjera cilësuese” në bashkëpunim (në formën e organizatës kriminale), të parashikuar nga nenet 79/dh/e/ - 28 të Kodit Penal në ngarkim të subjekteve të posaçëm sipas përcaktimit të nenit 75/a të KPP – qartazi refuzues i pranimit të saj - përse kohë - që evidenton arsyet justifikuese të këtij qëndrimi të identifikuar në “mungesën e indicjeve për elemente të figurës së veprës penale në ngarkim të subjekteve të posaçme të kallëzuar, të parashikuar nga neni 75/a i KPP - e konfirmuar kjo situatë provuese prej rezultateve – dinamikës – së hetimeve (paraprake) të zhvilluara në kuadrin e procedimit penal të regjistruar për të njëjtin fakt penal (ngjarje kriminale) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë – përmbajtja e të cilave (megjithëse është hetuar lidhur me nivelin ekzekutiv realizues të vrasjeve dhe të plagosjeve të demonstruesve, përfshirë edhe viktimën Aleks Nika) – nuk referon asnjë të dhënë në këtë drejtim”- përmban rekuizitat (e karakterit formal dhe substancial) të vendimit të mosfillimit (mosregjistrimit) të procedimit – të parashikuar në paragrafin e parë, të nenit 291 të KPP.

30. Veshja e këtij konkluzioni nën “petkun” e “kalimit të akteve” (të kallëzimit të refuzuar – për të qenë të saktë) tek prokurori “kompetent” duke paraqitur si reference përcaktimin e paragrafit të tretë, të nenit 29 të KPP (që bën fjalë për eventualitetin e verifikimit të një konflikti pozitiv të “kompetencës” së hetimit të prokurorit të posaçëm me prokurorin pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm - të zgjidhshëm në mënyrë të njëanshme prej drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme) – sipas konsideratës së këtij Kolegji – nuk paraqet asnjë lloj ndikimi në drejtim të:

1. nihilizimit të përmbajtjes së konkluzionit – në cilësinë e tij të prononcimit refuzues (të Prokurorit) të regjistrimit (në thelb të refuzimit të fillimit të procedimit penal) të njoftimit/lajmit - të marrë nëpërmjet kallëzimit të viktimës - në regjistrin e njoftimit të veprave penale – të motivuar - në konformitet me përcaktimin e paragrafit të parë, të nenit 291 të KPP – me papërshtatshmërinë për të disponuar cilësitë/rekuizitat e njoftimit për veprën penale – notitia criminis – e identifikuar (kjo papërshtatshmëri) me “mungesën e indicjeve individualizuese të prezencës së veprës penale në ngarkim të subjekteve të posaçëm të kallëzuar”

2. të paragjyqimit (për pasojë)- të të drejtës së kësaj të fundit – viktimës kallëzuese – të parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 291 të KPP – për të ankimuar – para gjyqtarit për



hetimet paraprake – konkluzionin thelbësor në përmbajtje të këtij disponimi dhe – në të njëjtën kohë.

3.të paragjyqimit të detyrimit të këtij të fundit (gjyqtarit për hetimet paraprake) për t'u prononcuar, nën stimulim e këtij ankimi, lidhur me ligjshmërinë e vendimmarrjes së prokurorit.

31. Në këtë stad të ecurisë/dinamikës së itinerarit logjik të arsyesimit të këtij vendimi Kolegji gjen me vend të ndalet në problematikën e siperevidentuar – të parashikuar prej përmbajtjes së dispozitave të KPP – konkretisht të neneve 280 – 287 të KPP - që parashikojnë “marrjen dijani për veprën penale” (prej organit të procedimit penal – prokurori dhe policia gjyqësore) në të gjitha format e shfaqjes së saj (llojet e kallëzimeve), dokumentimin e kësaj dijenie nëpërmjet “regjistrimit të njoftimit të veprave penale”(neni 287 i KPP) për të kaluar tek – kontrolli juridiksional – i ushtruar prej gjyqtarit për hetimet paraprake – nën stimulimin e palëve (kallëzuesi, viktimë) – lidhur me disponimin e prokurorit – inercinë e tij - për të regjistruar procedimin penal (sikurse në rastin konkret) mbi bazën e njoftimit të marrë nëpërmjet kallëzimit të paraqitur prej viktimës (trashëgimtarëve të afërm të saj) – përse kohë që disiplina e mirëfilltë e mosfillimit apo mosvazhdimin të procedimit të regjistruar (për shkak të mungesës apo rënies - përgjatë ecurisë së procedimit penal – të kushteve të procedimit, të parashikuara në nenin 290 – paragrafi i parë - i KPP) – nuk interferon në rastin në fjalë që sugjeron impenjimin e drejtpërdrejtë të legjislatorit për të “ndërhyrë” - nëpërmjet parashikimit të aplikimit (ushtrimit) të kontrollit juridiksional - edhe në këtë fushë - të konsideruar historikisht si “domen” i aplikimit të diskrecionit ekskluziv (pothuajse të pakontrollueshëm prej organit juridiksional) të prokurorit - lidhur me marrjen dhe regjistrimin e njoftimit për veprën penale (notitia criminis) – në funksion të disiplinimit dhe të kontrollit të këtij diskrecioni me rëndësi thelbësore për zbatimin/jetësimin e parimit kushtetues të barazisë së shtetasve para ligjit nëpërmjet ushtrimit të detyrueshëm të ndjekjes penale.

32. Fillimi i procedimit penal presupozon ekzistencën e një njoftimi/lajmi për veprën penale – tradicionalisht e konsideruar si “informacion i marrë nga prokurori apo nga policia gjyqësore lidhur me një fakt që përbën vepër penale”. Mënyrat e marrjes së njoftimit për veprën penale parashikohen në nenet 281, 282 dhe 283 të KPP dhe identifikohen në “kallëzimin e n/punësve publike, “kallëzimi nga personeli mjekësor” dhe “kallëzimi nga ana e shtetasve”. Prokurori ka detyrimin të regjistrojë – shënoje – në regjistrin e njoftimeve të veprave penale – çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që e ka siguruar me iniciativë i kompletuar në eventualitet edhe me emrin e autorit të kësaj vepre.

33. Konsiderohet në cilësinë e njoftimit (objektiv) për veprën penale - njohja e thjeshtë e fakteve - të përshkruara - në këtë njoftim/lajm – si (fakte) të “ndodhura”, “ të rëndësishëm” dhe konkrete” – korresponduese - në mënyrë të drejtpërdrejtë – tek një normë inkriminuese - Detyrimi i prokurorit për të shënuar në regjistrin e parashikuar nga neni 287 i KPP – një njoftim për veprën penale – notitia criminis - në ngarkim të një subjekti të caktuar “lind” vetëm kur në ngarkim të këtij të fundit dalin/evidentohen (mbi bazën e materialit kallëzues) elementë specifike të karakterit indicjar – standard provues që përjashton - duke konsideruar në kushtet e pamjaftueshmërisë – dyshimet e thjeshta. Shënimi në regjistrin e njoftimit të veprave penale të prokurorit - i njoftimit për veprën penale - kristalizon momentin gjenetik të fazës së procedimit – të hetimeve paraprake – të destinuar për të përfunduar me “kërkesën për dërgimin e çështjes në gjykim” apo “ për pushimin e çështjes”.

34. Në terma të tjerë informacioni i “transportuar” nëpërmjet njoftimit/lajmit për t'u kualifikuar në cilësinë e njoftimit për veprën penale – të notitia criminis – duhet domosdoshmërisht të përmbajë tiparet dalluese të faktit – vepër penale - të identifikueshme në elementin (anën) objektiv të figurës së veprës penale – veprimin kriminal, pasojën dhe lidhjen shkakësore.

35. Neni 280 i KPP percakton dy mënyra të marrjes dijani (prej organit të procedimit penal – prokurorit dhe policisë gjyqësore) për veprën penale – nëpërmjet “njoftimit të bërë nga

të tjerët” dhe “me iniciativën e vet”. Në rastin e parë si policia gjyqësore është edhe prokurori luajnë një rol “pasiv” përse kohë që “operojnë” në cilësinë e “pritësit” të informacionit të ardhur nga “kanale të kualifikuara” (të identifikuar sikurse u sipërcitua në kallëzimet e nëpunësve publike, të personelit mjekësor dhe të shtetasve sipas përcaktimeve të neneve 281, 282, dhe 283 të KPP) dhe nuk kanë asnjë lloj roli në formimin e këtyre akteve. Ndërkohë që në rastin e dytë – të “marrjes së njoftimit me iniciativën e vet” – konfigurimet – një veprimtari paraprocedurale e këtij organi (të procedimit – prokurori) - kërkimi dhe rikoncicioni të informacionit në “kanale të pakualifikuara” që synon verifikimin e transformimit të tij në njoftim (notitia criminis) legjitim për veprën penale - të përshtatshëm për t’u regjistruar në konformitet me përcaktimet e paragrafit të parë, të nenit 287 të KPP. Në të gjitha këto raste (bëhet fjalë për informacione të ardhura nga burime konfidenciale, operacione nën mbulim, nga fakte të njohura botërisht, nga burime anonime, nga shtypi – mass media – përfshirë shërbimet radiotelevizive dhe investigimet e gazetarisë etj.) prokurori me të marrë (edhe me iniciativën e tij) të dhënë nga burimet e njohjes (informimit) të sipërcituar duhet të kryejë një aktivitet investigues në funksion të verifikimit të prezencës së një njoftimi të mirëfilltë për veprën penale. Mbi këtë bazë edhe përmbajtja e një bisede telefonike të përgjuar në mënyrë të paligjshme e cila në vetvete nuk mund të disponojë cilësitë e njoftimit – notitia criminis - për veprën penale - për shkak të kësaj paligjshmerie, mund të shërbejë si shtysë e dobishme për të investiguar (hetuar) në drejtim të formimit të kësaj të fundit - notitia criminis - me rekuizitat e përshtatshëm për t’u regjistruar. Vetëm brenda këtyre limiteve mund të konceptohet lejimi i veprimtarisë së kërkimit të njoftimit (për veprën penale) – prej prokurorit – veprimtari - e cila – “materializohet” në një fazë paraprocedimorë të verifikimit të ekzistencës dhe të rëndësisë së informacionit të marrë.

36. Duke u rikthyer tek përmbajtja e njoftimit për veprën penale – kushtet e regjistrueshmërisë së saj (rekuizitat e identifikuese të kësaj cilësie – që informacioni i marrë prej organit procedues – të integrojë cilësinë e notitia criminis – njoftimit për veprën penale – është e mjaftueshme – duke mbajtur si referim përcaktimin e nenit 293/1 të KPP (I vetmi referim kodifikues lidhur me konceptin – nocionin – e njoftimit për veprën penale) që bën fjalë për referimin e veprës penale nga policia gjyqësore tek prokurori – të disponojë (përmbaje) “elementet thelbësore të faktit” – të identifikueshëm në komponentët e anës objektive të figurës së veprës penale të tilla si sjellja (veprimi) kriminal, pasoja dhe lidhja shkakësore.

37. Përbëjnë – sipas konsideratës së këtij Kolegji – elemente karakterizues të identifikimit të notitia criminis – njoftimit për veprën penale – 1. hipoteticiteti (i saj) përse kohë që qartazi “njoftimi për veprën penale” në çfarëdo lloj forme që materializohet përbën esencialisht një hipotezë krimi (vepre penale) që prezanton një profil të dyfishtë - I pari që i referohet objektit d.m.th. ekzistencës së një fakti dhe kualifikimit të tij si krim (vepër penale) - i dyti – tregimit të përgjegjësitet eventuale (autoritet) të realizimit të këtij fakti si dhe të dënueshmërisë së tij – dhe 2. specificiteti - që shërben për t’i dhënë një sens konkret njoftimit (për veprën penale) dhe për ta dalluar atë nga dyshimi i thjeshtë apo hamendja - të dhëna njohëse këto – të cilat për nga natyra e tyre – konsiderohen të vakëta dhe të papërcaktuara.

38. Termi “njoftimi për veprën penale” i përdorur rëndom nga legjislatori në KPP mbështetet përreth dy “shtyllave”: njoftimi/lajmi dhe vepra penale. I pari, sipas gjuhës së përditshme është një informacion që bën të njohur një fakt, nga deduktohet se thelbin e përmbajtjes së këtij njoftimi/lajmi e përbën informacioni i sipërcituar. Kur mungon përmbajtja e këtij informacioni - në kushtet kur - fakti i referuar nëpërmjet tij rezultojnë jashtë çdo lloj konteksti hapësirë apo kohe, është në kushtet e pamundësisë për t’u realizuar apo është prodhim i fantazisë – nuk mund të bëhet fjalë për njoftim në aspektin teknik. I dyti (vepra penale) – ka të bëjë- përcakton - objektin të cilit i referohet njoftimi – që dedukton konkluzionin se: “njoftimi/lajmi mbi një fakt që - prima facie – përbën (njofton) një paligjshmëri të karakterit civil apo administrativ ose që nuk rezultojnë juridikisht i rëndësishëm – përfaqëson një

njoftim/lajm jo për një veprë penale” - dhe si i tillë – i paaftë për të “influencuar” aktivimin (regjistrimin) e procedimit penal.

39. Duke u kthyer tek rasti konkret – paraqitja e kallëzimit të viktimës Nikaj, tek organi i procedimit penal – prokurori (Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar) - sekretaria e këtij të fundit - Kodi i Procedures Penale, në Titullin I të tij ku përcakton subjektet e procedimit penal - ndër të tjerë - në nenet 58, 58/a dhe 58/b - identifikon si të tillë “viktimën e veprës penale”. Rëndësia e këtij subjekti procedural është treguar nga ligjvënësi që me shtimin e nenit 9/a<sup>1</sup>, në përbërje të këtij Kodi, duke theksuar detyrimin e organeve publike që të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga Kodi. Neni 58 i KPP, megjithëse në pikën 1 të tij tregon të drejtat e viktimës së veprës penale, nuk jep një përkufizim të këtij termi. Në fakt, një përkufizim i tillë nuk jepet as nga ndonjë dispozitë tjetër e Kodit.

40. Në interpretim të kësaj dispozite, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje përkufizimin e termit “viktimë e veprës penale” sipas Direktivës 2012/29/BE të Parlamentit dhe Komisionit Europian datë 25.10.2012 “Për përcaktimin e standardeve minimum për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimës së veprave penale dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Komisionit 2001/220/JHA” (Direktiva 2012/29/BE), në të cilën është bazuar ndryshimi i bërë në KPP me ligjin nr. 35/2017. Referuar kësaj direktive, me viktimë të veprës penale kuptohet: (i) individ që ka pësuar një dëm, përfshirë dëmin fizik, mendor, emocional, apo ekonomik, i cili është shkaktuar drejtpërdrejtë nga vepra penale (neni 2, shkronja (a), pika (i)); (ii) anëtar i familjes së personit, vdekja e të cilit është shkaktuar nga një veprë penale dhe i cili ka pësuar një dëm si rezultat i vdekjes së personit (neni 2, shkronja (a), pika (ii)).

41. Referuar përkufizimit të mësipërm, si dhe faktit që kallëzuesja Rajmonda Nika, është bashkëshortja e një prej personave që njoftohet se është vranë si pasojë e veprimeve kriminale të realizuara prej “forcës publike”, në ngjarjen e datës 21.01.2011 (objekt hetimi), Kolegji vlerëson se ajo paraqitet me cilësinë e viktimës së veprës penale, të cilës Kodi i njeh të drejtat e parashikuara në nenin 58 të tij. Qëllimi i kësaj dispozite (neni 58 të KPP) është të përcaktojë pozitën e viktimës në procesin penal, si dhe të drejtat e saj procedurale nga momenti i njoftimit të veprës penale e deri në përfundim të procesit. Neni 58 i KPP, rendit të drejtat e viktimës së veprës penale, të cilat mund të kategorizohen në të drejta eventuale (potenciale), të cilat viktimat mund të zgjedhë t’i ushtrorë ose jo dhe të drejta të detyrueshme, ushtrimi i të cilave passjell detyrimin e organit procedues për t’i plotësuar.

42. Në konsideratë të rastit konkret dhe përsa lidhen me të, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje disa nga të drejtat e viktimës së veprës penale. Një nga të drejtat e viktimës është të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit (neni 58/1, shkronja “a”, e KPP). Kjo e drejtë e viktimës së veprës penale lidhet me të drejtën e saj për të kërkuar që nga ana e organit të akuzës të ushtrohet ndjekja penale në rastet kur vepra ndiqet kryesisht ose me të drejtën e saj për të kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale, duke paraqitur ankim për rastet e parashikuara në nenin 284 të KPP. Neni 58 i këtij Kodi parashikon edhe të drejtën e viktimës së veprës penale që të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor (neni 58/1, shkronja “d” i KPP). Në këtë pikë, Kolegji thekson se e drejta e informimit të viktimës është një nga të drejtat thelbësore të saj, të cilat i mundësojnë akses në procedimin penal. Për rrjedhojë, duke pasur të drejtë për një

---

<sup>1</sup> Neni 9/a “Të drejtat e viktimës nga vepra penale” (Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017): “1. Gjatë procedimit penal, viktimat ka të drejtat e parashikuara nga ky Kod. 2. Organet publike duhet të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga ky Kod.”

informacion të tillë, është e qartë se kjo është një nga të drejtat themelore të procedurës, për respektimin e të cilës organi procedues duhet të tregojë kujdes të veçantë. Kjo e drejtë e viktimës lidhet me detyrimin e prokurorit për t'i vënë në dispozicion viktimës informacionin e kërkuar, me përjashtim të rasteve kur cenohet parimi i sekretit hetimor. Kjo e drejtë detajohet më tej në nenin 279/a<sup>2</sup> të KPP (dispozitë e shtuar me ligjin nr. 35/2017). Gjithashtu, viktima e veprës penale ka të drejtë të ketë informacion mbi fatin e hetimit dhe gjykimin (neni 58/1, shkronja “ë” i KPP). Kjo e drejtë e saj është reflektuar edhe në dispozitat e tjera të KPP, në të cilat ligjvënësi ka përcaktuar detyrimin e organit procedues përkatës për të njoftuar viktimën mbi fillimin, vijimin dhe përfundimin e procedimit penal. Konkretisht, në nenin 291, pika 2<sup>3</sup>, të KPP ligji parashikon detyrimin e prokurorit për t'i njoftuar menjëherë viktimës së veprës penale vendimin e mosfillimit të procedimit. Po kështu, në nenin 328, pika 2<sup>4</sup>, ligjvënësi ka parashikuar detyrimin e prokurorit për t'i njoftuar brenda 5 ditëve viktimës së veprës penale vendimin e tij për pushimin e akuzës ose çështjes në rastin kur procedohet për kundërvajtje. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrimin të njoftojë viktimën e veprës penale për të marrë pjesë si në seancën paraprake (neni 332/a, pika 1<sup>5</sup>), ashtu edhe në gjykimin e themelit (neni 333, pika 2<sup>6</sup>), si dhe t'i komunikojë asaj vendimin përfundimtar në rastet kur nuk është e pranishme në gjykim.

43. Kolegji konstaton se në rastin konkret, kallëzuesja (viktima) Rajmonda Nika, ka paraqitur (bashke me subjekte të tjerë - viktima të ngjarjes kriminale) kallëzim penal me shkrim pranë Prokurorisë së Posaçme, ne konformitet me përcaktimet e nenit 283 të KPP, (që parashikon kallëzimin e shtetasve) duke dhënë “njoftim për një veprë penale” që ndiqet kryesisht. Në këtë kallëzim përmbahen elementet thelbësor të faktit, burimet e provës, si dhe gjeneralitetet e personave që i atribuohet fakti penal, të cilët për aq sa identifikohen përkojnë me subjekte të posaçme në kuptim të nenit 75/a të KPP. Nga ana tjetër, konstatohet se Prokuroria e Posaçme – prokurori - që ka marrë këtë “njoftim për veprë penale” - nëpërmjet drejtuesit të saj- me shkresën Nr.K. 137/1.Prot. A/SH, datë 24.02.2023 – ndonëse - në thelb - është shprehur për “papërshtatshmërinë e këtij njoftimi për të integruar ciësitë e njoftimit për veprën penale – notitia criminis – për shkak të mungesës së indicieve individualizuese të kryerjes së veprës penale prej subjekteve të posaçëm të kallëzuar – i konfirmuar ky konkluzion (gjithnjë sipas përmbajtjes së disponimit të prokurorit) edhe prej hetimeve të zhvilluara prej kohësh por edhe aktualisht lidhur me këtë ngjarje - prej prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë – ka dërguar kallëzimin – “njoftimin për

<sup>2</sup> “1. Për shkaqe të ligjshme, viktima, përfaqësuesi ligjor ose mbrojtësi i saj kanë të drejtë të kërkojnë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihen dhe të marrin kopje të akteve dhe provave që ndodhen në fashikullin e prokurorit. 2. Prokurori mund të refuzojë kërkesën kur: a) interesi i ruajtjes së fshehtësisë së hetimit tejkalon interesin e viktimës; b) interesi i të pandehurit tejkalon interesin e viktimës; c) viktima nuk është pyetur ende si dëshmitar. 2. Viktima, përfaqësuesi ligjor ose mbrojtësi i saj kanë të drejtë të kërkojnë informacion në lidhje me vendosjen, vazhdimin, zëvendësimin apo heqjen e masave të sigurimit ndaj të pandehurit, përveçse kur njoftimi për këto fakte mund të rrezikojë jetën ose shëndetin e të pandehurit.”

<sup>3</sup> Neni 291/2 i KPP: “2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.”

<sup>4</sup> Neni 328/2 i KPP: “2. Prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, duke u bërë të ditur të drejtën për t'u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë.”

<sup>5</sup> Neni 332/a, pika 1 i KPP: “1. Gjyqtari i seancës paraprake njofton të pandehurin dhe viktimën ose trashëgimtarët e saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, duke treguar ditën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet seanca, me paralajmërimin për të pandehurin se nëse nuk paraqitet, seanca do të zhvillohet në mungesë të tij.”

<sup>6</sup> Neni 333/2 i KPP: “2. Data e seancës i njoftohet prokurorit, të pandehurit, mbrojtësit, viktimës, palëve private dhe përfaqësuesve të tyre të paktën dhjetë ditë para datës së caktuar për gjykim.”



veprën penale” - për “kompetencë lëndore” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

44. Kolegji – sikurse qartësisht është prononcuar përgjatë “rrugetimit” llogjik të argumentimit të qëndrimit të adoptuar – disponimin e prokurorit (drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme) për të “dërguar” - nën petkun procedural të “kalimit të akteve” (në konformitet me përcaktimin e nenit 29/1 të KPP) – kallëzimin (nëpërmjet të cilit është njoftuar për veprën penale të “vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 78/dh/e/ të Kodit Penal, të kryer nga subjekte të posaçëm, në kompetencë hetimi të Prokurorisë së Posaçme sipas përcaktimit të nenit 75/a të KPP) – në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë - e ka konsideruar për atë që realisht dhe thelbësisht përfaqëson – në cilësinë e “deklarimit të papërshtatshmërisë së përmbajtjes së kallëzimit të viktimës për të disponuar rekuizitat/cilësitë e njoftimit (notitia criminis) për një vepër penale me pasojë refuzimin për këtë shkak për ta rregjistruar në rregjistrin e njoftimit të veprave penale në konformitet me përcaktimet e nenit 287/1 të KPP”, qëndrim që (pavarësisht mveshjes formale të tij – sipas përcaktimit të nenit 29/1 të KPP – nën formën e “kalimit të akteve”) natyrshëm dhe në mënyrë legjitime ka “provokuar” reagimin ankimues të viktimës kallëzuese – në konformitet me përcaktimet e paragrafit të dytë, të nenit 291 të KPP – për të aktivuar kontrollin juridiksional lidhur me ligjshmërinë e këtij disponimi – të “besuar” – sipas përcaktimit të paragrafit të tretë, të nenit 291 të KPP - gjyqtarit për hetimet paraprake – pranë Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – i cili gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake.

45. Mbi këtë bazë Kolegji konsideron disponimet mospranuese të Gjykatave të Posaçme (të shkallës së parë – gjyqtari për hetimet paraprake pranë saj – dhe të Apelit) – legjitimuese të ometimit të trajtimit (prononcimit) lidhur me aspektin thelbësor të disponimit të prokurorit (të evidentueshëm ictu oculi në përmbajtjen e “shkresës” nr. K.137/1.prot. A/SH, datë 23.02.2023, të prokurorit – drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme) nën stimulën e ankimit (të ankimeve) të paraqitura nga viktimat - nën justifikimin e “pamundësisë së ankimit të disponimit të prokurorit për atribuimin e kompetencës një organi tjetër (prokurorie) procedimi” – në kushtet e paligjshmërisë – të cenimit të të drejtës së aksesit të palës (viktimë) në gjykatë – lidhur me të drejtën për të aktivuar kontrollin juridiksional - edhe në këtë fazë të hershme parajuridiksionale të procedimit penal – mbi diskrecionin e prokurorit në cilësinë e titullarit të kësaj faze të hetimeve paraprake (dhe në analizë të fundit – të titullarit të ushtrimit të ndjekjes penale) - për të disponuar në kushte ekskluziviteti – në konformitet me përcaktimet e neneve 280 – 287 të KPP - lidhur me “njoftimet për veprat penale” – (të marra nga të tjerët apo me iniciativë) kushtet e regjistrueshmërisë së tyre – pershtatshmërisë për të disponuar cilësitë e “notitia criminis”.

46. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë - në këto kushte – të konstatimit të paligjshmërisë së disponimeve ometuese të gjykatave të posaçme të dy shkallëve për të trajtuar ankimet e viktimës dhe për t’u prononcuar lidhur me disponimin e prokurorit të posaçëm – refuzues të regjistrimit të procedimit penal mbi bazën e kallëzimit të paraqitur prej kësaj të fundit – të motivuar me papërshtatshmërinë e njoftimit (të marrë nëpërmjet kallëzimit) për të disponuar cilësitë e notitia criminis (mungesë e indicieve individualizuese të kryerjes së veprës penale prej subjekteve të posaçëm të kallëzuar) - në zbatim të të drejtës së viktimës - të legjitimuar prej përcaktimeve të neneve 283, 287, pika 1 dhe 291, pikat 2, 3 dhe 4 të Kodit të Procedurës Penale – për të kërkuar nëpërmjet paraqitjes së kallëzimit - regjistrimin e procedimit penal dhe në kushtet e refuzimit të regjistrimit – për të ankimuar - disponimin refuzues të prokurorit – konsideron se vendimmarrjet e gjykatave të posaçme – gjyqtarit për hetimet paraprake pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Gjykatës së Posaçme të Apelit duhet të ndryshohen dhe se – në konformitet me përcaktimet e gremës “dh”, të paragrafit të parë, të nenit 441 të KPP – verifikohen kushtet “për të zgjidhur në mënyrë përfundimtare

çështjen” - duke urdhëruar Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për të regjistruar procedimin penal për kallëzimin e datës 16.02.2023 - te paraqitur nga viktimja Nikaj.

47. Në kundërshtim me konkluzionet e prokurorit që justifikon - sikurse u sipërcitua – refuzimin e regjistrimit të njoftimit të marrë nëpërmjet kallëzimit të viktimës Nikaj (mosfillimin e procedimit penal) – me papërshtatshmërinë e tij (njoftimit) për të disponuar cilësitë e notitia criminis për shkak të “mungesës së indicieve” individualizuese të kryerjes së veprës penale të “vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 79/dh/e/ - 28 të Kodit Penal – prej subjekteve të posaçëm të indikuara qartazi në kallëzim në cilësinë e ish – kryeministrit të kohës së ndodhjes së ngjarjes Sali Berisha, ish – ministrit të Brendshëm Lulzim Basha, ish – komandantit të Gardes Ndrea Prendi – situatë provuese – e konfirmuar (gjithnjë sipas këtyre konkluzioneve) prej hetimeve të zhvilluara historikisht dhe aktualisht – lidhur me “të njëjtin fakt kriminal” – në kuadrin e procedimit penal të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Kolegji, në mbështetje të qëndrimit afirmues të prezencës së kushteve të regjistrueshmërisë së kallëzimit të identifikuar në evidentimin e njoftimit (notitia criminis) për veprën penale – indicieve individualizuese (në cilësinë e standardit provues identifikues të këtij njoftimi dhe mundësues, për pasojë, i regjistrimit të tij në regjistrin e njoftimit të veprave penale) të bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale të sipërcituar edhe prej subjekteve të indikuara në kallëzim – konsideron këtë konkluzion jo vetëm të pabazë – në kushtet kur prej prokurorisë së zakonshme (e cila prej vitit 2011, menjëherë mbas ngjarjes – më datë 21 janar 2011 – është aktivuar për hetimin e çështjes – të riçelur në vitin 2021) asnjëherë nuk është tentuar (për shkaqe nga më të ndryshme – përfshirë edhe mungesën e kompetencës) për të shtrirë hetimet - lidhur me “ngjarjen e 21 janarit” – ku mbeten të vrarë katër demonstrues dhe të plagosur dhjetëra të tjerë – nga zjarri i armëve të përdorura nga efektive të Gardës Kombëtare të “barrikaduar” në brendësi të selisë së Kryeministrit - të ndodhur në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” – vendi i zhvillimit të manifestimit të organizuar nga opozita e kohës – përtej nivelit të mirëfilltë ekzekutues të krimit (krimeve) – të sipërcituar (efektivë të Gardës Kombëtare - përfshirë edhe nivelin komandues të saj) – por edhe të paballafaquar minimalisht (në të njëjtën kohë) me indiciet individualizuese – evidentuese të implikimit të nivelit më të lartë drejtues shtetëror – përfshirë Kryeministrin dhe Ministrin e Brendshëm të kohës - përtej atij të mirëfilltë ekzekutues – të vëna në dispozicion të organit të procedimit.

48. Sa i përket pretendimit të Prokurorisë së Posaçme (të shprehur në seancë gjyqësore) për praktikën e mëparshme të Kolegjit Penal dhe Gjykatës Kushtetuese në lidhje me cilësimin juridik dhe legjitimitimin e kallëzuesit/viktimës për të paraqitur ankim (rekurs) ndaj shkresës së drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për kalimin e akteve për kompetencë lëndore prokurorisë së zakonshme, Kolegji vlerëson se situata për rastin konkret nuk është identike dhe, si i tillë, ky pretendim është i pabazuar. Në situatën konkrete, Kolegji vlerëson se përveçse sa më sipër shtjelluar, duhet mbajtur në konsideratë ndërhyrja ndërkohë e prononcimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), (vendimi datë 14 Nëntor 2023 - çështja Nika kundër Shqipërisë), lidhur me rastin konkret -objekt shqyrtimi. GJEDNJ në përfundim të ekzaminimit të çështjes konstatoi - shkelje të nenit 2, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si në aspektin material ashtu dhe në atë procedural. Gjykata evidentoi mangësi specifike në hetimin për vdekjen e të afërmeve të kërkuesve dhe konkludoi se autoritetet kanë dështuar për kryerjen e një hetimi efektiv për ngjarjen, i cili duhet të çonte në zbulimin e të vërtetës dhe identifikimin e ndëshkimit të përgjegjësve (paragrafi 128-129 i vendimit). Gjithashtu, GJEDNJ konstatoi se çështja e përgjegjësisë së mundshme të zinxhirit komandues të Gardës nuk ishte zbardhur nga hetimi përkatës, i cili ishte përqendruar në përgjegjësinë individuale të oficerëve të Gardës dhe jo në sekuencën apo natyrën e urdhrave që mund të ishin dhënë nga zinxhiri komandues. Kishte pasur gjithashtu edhe një sërë

mangësish të tjera në hetim duke përfshirë fshirjen e video-regjistrimeve të incidentit dhe mosndjekjen e disa pistave kyçe të hetimit, si shenjat e plumbave të gjetura në lartësinë e njeriut në gardhin e hekurt që rrethon Kryeministrinë. Këto mangësi ngritën dyshimin se autoritetet ishin përpjekur ta devijonin apo të ndërhyenin në hetim (paragrafi 109 i vendimit).

49. Kolegji çmon të evidentojë – me këtë rast - se – në konformitet me përcaktimet e nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut - Palët Kontraktuese (ku përfshihet edhe Shqipëria) – kanë detyrimin e konformimit ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës (GJEDNJ), në çdo çështje ku ato janë palë, përmes ekzekutimit të tyre. Një nga efektet e kësaj procedure është se në rastet kur GJEDNJ konstaton shkelje, shteti i paditur ka detyrimin ligjor jo vetëm për të paguar personave përkatës shumat e dhëna si shpërblim i drejtë, në bazë të nenit 41, por edhe për të zgjedhur masat e përgjithshme dhe/ose individuale më të përshtatshme që duhet të ndërmerren për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga GJEDNJ. Në këtë kontekst, Kolegji sjell në vëmendje se përsa i përket masave individuale dhe zbatimin e nenit 46 të Konventës, në paragrafin 178 të vendimit, është shprehur se, *“Gjykata vëren se hetimi penal është ende i hapur. Duke pasur parasysh këtë, ajo konsideron se autoritetet duhet të vazhdojnë (për aq sa kjo është e mundur) përpjekjet e tyre që synojnë zbardhjen e rrethanave të vdekjes së A.N. dhe identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës, aty ku është e përshtatshme.”* Rrjedhimisht, duke mbajtur parasysh (edhe) konkluzionet e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të datës 14 Nëntor 2023 (çështja Nikaj kundër Shqipërisë), lidhur me zgjidhjen efektive dhe për forcën detyruese dhe ekzekutimin e vendimeve të kësaj Gjykate, edhe për këtë shkak, Kolegji konsideron se vendimet e gjykatave të posaçme (gjyqtarit për hetimet paraprake pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Gjykatës së Posaçme të Apelit) duhet të ndryshohen, duke u urdhëruar Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për të regjistruar procedimin penal, për kallëzimin e datës 16.02.2023, me qëllim kryerjen e hetimeve të mëtejshme, duke mbajtur në konsideratë edhe vendimmarrjen e mësipërme të GJEDNJ.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në konformitet me përcaktimet e neneve 291, pika 4 dhe 441, pika 1, shkronja “dh”, të Kodit të Procedurës Penale

### **VENDOSI:**

Ndryshimin e vendimit nr. 92, datë 21.06.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe të vendimit nr. 107, datë 29.03.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – gjyqtarit për hetimet paraprake pranë asaj gjykate dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes, duke urdhëruar Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për të regjistruar procedimin penal për kallëzimin e datës 16.02.2023.

**Tiranë, më 12.03.2024**